

Nr. 17169 prot

dt. 09.08.16



**Grant Thornton**

An instinct for growth™

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a.

31 dhjetor 2015

## Përmbajtja

	<b>Faqe</b>
Raporti i Audituesit të Pavarur	3
Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar	7
Pasqyra e Konsoliduar e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	8
Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital	9
Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve të Parasë	10
Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara	11



**Grant Thornton**

An instinct for growth™

Grant Thornton Sh.p.k.  
Rr. Sami Frasherit, Kompleksi T.I.D, Shk. B,  
Floor 1, 10 000  
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832  
F +355 4 22 56 560  
www.grantthornton.al

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Për drejtimin e Grupit Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.a,

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëngjitur të Grupit Ujësjellës Kanalizime Sh.a dhe Shoqërive të Kontrolluara prej tij ("Grupi" ose "UKT"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar në 31 dhjetor 2015, pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe të tjera shënime shpjeguese.

### *Përgjegjësia e drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

### *Përgjegjësia e audituesit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi në lidhje me shumat dhe informacionet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

#### *Bazat për mosdhënien e opinionit*

Sikurse është paraqitur në shënimin 7, 'aktive afatgjata jo materiale', pasqyra e konsoliduare e pozicionit financiar të Grupit përfshin emrin e mirë për vlerën neto prej 956,084 mijë lekë, të njohur nga kombinimi i pasqyrave financiare të UKT Sh.a me HEC Lanabregas Sh.a në momentin e përthithjes (shënimi 1, paragrafi 1.3). Shoqëria mëmë UKT Sh.a ka kryer një vlerësim në lidhje me aktivet afatgjata të saj më datë 27 mars 2014 nga vlerësues të jashtëm ku është kryer edhe testi për rënie në vlerë të emrit të mirë për vlerën 260,753 mijë lekë, vlerë e cila është regjistruar në të njëjtën masë edhe në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2014. Në përcaktimin e rënies në vlerë të emrit të mirë është përdorur norma e aktualizimit në masën 8.7%. Në përcaktimin e normës së aktualizimit është konsideruar vetëm kostoja e kredive të UKT dhe nuk është marrë parasysh kostoja e kapitalit, e cila nëse do të përfshihej në vlerësimin e normës së aktualizimit, do të rriste normën e aktualizimit dhe për pasojë edhe masën e rënies në vlerë të emrit të mirë. Për më tepër, Grupi nuk ka kryer test për rënie në vlerë dhe nuk ka kryer ndonjë vlerësim në lidhje me indikatorët e mundshëm për rënie në vlerë, sikurse kërkohet nga Standardi Ndërkombëtar 3 'Kombinimi i Bizneseve', të emrit të mirë për të mbështetur masën e rënies në vlerë të regjistruar për emrin e mirë në vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015. Rrjedhimisht ne nuk jemi në gjëndje të përcaktojmë nëse rregullime për emrin e mirë janë të nevojshme.

Sikurse është paraqitur në shënimin 6, 'aktive afatgjata materiale', dhe shënimin 5 'Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme kontabël' pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Grupit përfshin, aktive në proces' në vlerë 1,026,003 mijë lekë të mbartura nga periudhat e mëparshme për punime të kryera nga nënkontraktore të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjelles Kanalizime (DPUK). Ne nuk na janë vënë në dispozicion dokumenta mbështetës të duhur edhe të mjaftueshëm për gjëndjen e aktiveve në proces më 31 dhjetor 2015 dhe 2014. Për më tepër, ne nuk kemi qënë në gjëndje të mbledhim evidencë të mjaftueshme përmes mjeteve alternative sa i përket balancave të aktiveve në proces në pasqyrat financiare të konsoliduara. Si rrjedhojë, në mungesë të evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme, ne nuk jemi në gjëndje të përcaktojmë nëse rregullime për aktivet në proces janë të nevojshme.

Sikurse është paraqitur në shënimin 6, 'aktive afatgjata materiale', pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Grupit përfshin, aktivin 'toka' në vlerë 2,155,486 mijë lekë, të mbartura nga periudhat e mëparshme bazuar në raportin e vlerësimit më datë 27 mars 2014, të kryer nga vlerësues të jashtëm. Raporti i vlerësimit nuk referon dhe nuk qartëson metodën e aplikuar për vlerësimin e aktivit 'toka'. Si rrjedhim ne nuk mund të kishim në dispozicion të dhëna të duhura dhe të mjaftueshme për të përcaktuar nëse ka nevojë për rregullime në lidhje me vlerën e aktivit toka' në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar të Grupit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014. Për më tepër, Shoqëria nuk ka kryer ndonjë regjistrim për riciklimin e fitimit nga rivlerësimi, nga rezerva e rivlerësimit në fitimin e pashpërndarë në mënyrë graduale ose në momentin e transferimit të aktiveve, sikurse kërkohet nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit ("SNK") 16, "Aktivet Afatgjata Materiale".



Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Grupit përmban llogari të arkëtueshme në vlerë neto 2,716,829 mijë lekë. Sikurse paraqitet në shënimin 5 të pasqyrave financiare të konsoliduara, Shoqëria mëmë UKT Sh.a ka kryer një çmuarje për zhvlerësim për llogaritë e arkëtueshme bazuar mbi përqindje të paracaktuara mbi 4 klasa të riskut në bazë të numrit të faturave të papaguara për çdo kategori klientësh. Metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjeve të përdorura për provigjionimin e llogarive të arkëtueshme.

Për më tepër, metodologjia e aplikuar nuk është në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 39, i cili kërkon vlerësim individual për balancat e arkëtueshme individualisht të rëndësishme dhe vlerësim kolektiv për balancat e tjera bazuar në analize të plote mbështetur mbi të dhëna historike. Si rrjedhojë, në mungesë të përdorimit të një metodologjie e cila është në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 39, 'Instrumentat Financiare; njohja dhe matja' nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullime për gjendjet e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014.

Ne nuk ishim kontraktuar si audituesit e Grupit deri më 31 dhjetor 2015, dhe si rrjedhojë ne nuk kemi vëzhguar numërimin fizik të inventarit të Grupit në fillim dhe në fund të vitit. Ne nuk mundëm të merrnim siguri nëpërmjet procedurave alternative në lidhje me sasinë dhe vlerat e mbartura të inventarit më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 të cilat janë paraqitur në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar të Grupit përkatësisht në shumat 378,142 mijë Lek dhe 394,680 mijë Lek. Ne nuk mundëm të siguroheshim me evidencën e duhur dhe të mjaftueshme në lidhje me gjendjen e inventarit dhe të rënies së vlerës së tij. Si rezultat i këtyre çështjeve ne nuk mund të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim mund ketë qenë i nevojshëm në lidhje me inventarin e regjistruar apo të paregjistruar dhe elementët që përbëjnë pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014.

Më 31 dhjetor 2015, ka disa çështje gjyqësore të ngritura për pretendime në vlerën 100,961 mijë kundër UKT Sh.a apo nga UKT Sh.a. Grupi nuk ka vlerësuar dhe njohur, nëse është e nevojshme, një fond provigjioni në lidhje me detyrimet e mundshme që mund të lindin nga vendimet e gjykatave. Si rezultat i këtyre çështjeve ne nuk mund të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim mund ketë qenë i nevojshëm në lidhje me detyrimet e mundshme për çështjet gjyqësore të ngritura kundër Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015.

Sikurse është pasqyruar në shënimin shpjegues 13 'Huamarrje afatshkurtra,' të pasqyrave financiare të konsoliduara të Grupit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, gjëndja e detyrimeve të Grupit ndaj Ministrisë së Financave është respektivisht 1,031,747 mijë dhe 1,886,462 mijë Lek. Grupi nuk ka kryer vlerësimin e detyrimit ndaj Ministrisë së Financave duke përdorur kursin e fundvitit sipas kërkesave të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 21; 'Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit'. Për më tepër, Grupi nuk ka kryer njohjen me vlerën e drejte në ditën e parë të marrjes së huave si dhe nuk ka aplikuar më pas metodën e kostos së amortizuar mbi huatë e marra. Si rrjedhojë, ne nuk mund të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm në lidhje me detyrimet e huave dhe elementët që përbëjnë pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave përmbledhëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014.

Sikurse është pasqyruar në shënimin shpjegues 17 të pasqyrave financiare të konsoliduara të Grupit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, gjëndja e granteve qeveritare të shoqërisë është respektivisht 494,103 mijë Lek dhe 509,383 mijë Lek. Ne nuk na janë vënë në dispozicion dokumenta justifikues të duhur edhe të mjaftueshëm për gjëndjen e granteve qeveritare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014. Për më tepër ne nuk kemi marrë ende konfirmim të shkruar për gjëndjen e granteve qeveritare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 nga Drejtoria e Thesarit. Si rrjedhojë, ne nuk mundëm të merrnim siguri lidhur me vlefshmërinë dhe plotësinë e gjëndjes së granteve qeveritare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë mëme UKT Sh.a të vitit paraprak janë audituar nga një auditues tjetër. Ne nuk kemi qënë në gjëndje të mbledhim evidencë të mjaftueshme përmes mjeteve alternative sa i përket të ardhurave të njohura në pasqyrat financiare të Shoqërisë mëme UKT Sh.a më 31 dhjetor 2014. E ardhura e vitit krahasues ka ndikim në performancën financiare dhe rrjedhën e parasë të periudhës krahasuese dhe aktuale, dhe për rrjedhojë ne nuk jemi në gjëndje të përcaktojmë nëse rregullimet për këto vlera të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe në pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që perfundoi më 31 dhjetor 2015 janë të nevojshme.

#### *Opinion*

Per shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin "Bazat për mosdhënien e opinionit", ne nuk kemi qënë në gjëndje të sigurojmë evidence të nevojshme të auditimit për të bazuar opinionin tonë. Rrjedhimisht, ne nuk shprehim një opinion mbi keto pasqyra financiare.

*Kledion Kodra, FCCA*

Grant Thornton sh.p.k.

*Kodra*

Tiranë, Shqipëri  
17 korrik 2016



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015


Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

## Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2015 mijë Lek	31 dhjetor 2014 mijë Lek Riparaqitur	31 dhjetor 2013 mijë Lek Riparaqitur
<b>Aktivet</b>				
<b>Aktivet afatgjata</b>				
Aktive afatgjata materiale	6	12,702,649	12,379,777	12,006,408
Aktive afatgjata jo materiale	7	956,084	1,216,837	1,477,587
<b>Total i aktiveve afatgjata</b>		<b>13,658,733</b>	<b>13,596,614</b>	<b>13,483,995</b>
<b>Aktivet afatshkurtra</b>				
Inventari	8	378,142	394,680	356,843
Llogari të arkëtueshme	9	2,716,829	1,882,903	1,614,565
Mjete monetare dhe të ngjashme	10	396,917	11,590	16,019
<b>Total i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>3,491,888</b>	<b>2,289,173</b>	<b>1,987,427</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>17,150,621</b>	<b>15,885,787</b>	<b>15,471,422</b>
<b>Detyrimet dhe Kapitali</b>				
<b>Kapitali</b>				
Kapitali aksioner	11	2,544,398	2,544,398	2,544,398
Rezerva nga rivlerësimi		3,219,601	3,219,601	3,219,601
Rezerva ligjore		80,475	79,746	79,746
Rezerva statutore		3,681	3,681	3,681
Fitimi i mbartur		809,399	374,606	(205,981)
Fitimi i periudhës		533,045	434,793	580,587
<b>Kapitali neto</b>		<b>7,190,599</b>	<b>6,656,825</b>	<b>6,222,032</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>				
Huamarrje afatgjata	12	5,188,890	5,751,744	6,026,193
Grante	14	494,102	509,383	525,138
Detyrimi tatimor i shtyre	24	671	16,534	-
<b>Total i detyrimeve afatgjata</b>		<b>5,683,663</b>	<b>6,277,661</b>	<b>6,551,331</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>				
Llogari të pagueshme dhe detyrime të përlogaritura	15	2,599,551	1,474,680	1,312,567
Detyrime ndaj personelit	16	77,897	14,393	45,002
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	17	189,850	330,209	352,549
Huamarrje afatshkurtra	13	1,409,061	1,132,019	987,941
<b>Total i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>4,276,359</b>	<b>2,951,301</b>	<b>2,698,059</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>9,960,022</b>	<b>9,228,962</b>	<b>9,249,390</b>
<b>Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit</b>		<b>17,150,621</b>	<b>15,885,787</b>	<b>15,471,422</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi i Drejtues i Grupit dhe janë firmosur në emër të tij më 31 dhjetor 2015 nga:

  
Redi Molla  
Drejtor i Përgjithshëm

  
Znj. Aida Sula  
Drejtor Ekonomik

Shënime shpjeguese nga faqa 11 deri në 55 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

## Pasqyra e Konsoliduar e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

	Shënime	31 dhjetor 2015 mijë lekë	31 dhjetor 2014 mijë lekë
<b>Të ardhura</b>			
Të ardhura nga shitjet	18	2,798,357	2,821,108
Të ardhura të tjera	19	143,161	138,108
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>2,941,518</b>	<b>2,959,216</b>
<b>Shpenzimet Operative</b>			
Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit	20	(924,153)	(804,743)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	6	(269,562)	(262,482)
Renie në vlerë e emrit të mirë	7	(260,753)	(260,753)
Rimarrje/(Shpenzime) provizione llogari të arketueshme	9	170,678	(84,373)
Rimarrje/(Shpenzime) provizione inventari	8	-	(32,373)
Rimarrje/(Shpenzime) provizione të tjera		3,178	10,784
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	21	(139,286)	(81,132)
Shpenzime personeli dhe të ngjashme	22	(869,097)	(771,549)
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>		<b>(2,288,995)</b>	<b>(2,286,621)</b>
<b>Të ardhura / shpenzime financiare</b>			
Shpenzimet financiare	23	(114,601)	(137,110)
Fitim (humbje) nga kembimit valutore		88,180	2,346
<b>Totali i të ardhura / shpenzime financiare</b>		<b>(26,421)</b>	<b>(134,764)</b>
<b>Fitimi (humbje) para tatimit mbi fitim</b>		<b>626,102</b>	<b>537,831</b>
Shpenzime tatimore	24	(93,057)	(103,038)
<b>Rezultati i vitit</b>		<b>533,045</b>	<b>434,793</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>533,045</b>	<b>434,793</b>

Shënimet shpjeguese nga faqa 11 deri në 55 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

31 dhjetor 2015

Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

## Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali Aksioner	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva te Rivleresimit te Aktiveve	Fitimi i Pashperndare	Totali
	mijë lekë	mijë lekë	mijë lekë	mijë lekë	mijë lekë	mijë lekë
Gjendja me 1 janar 2013	2,544,398	79,746	3,681	3,219,601	374,606	6,222,032
Rezultati i vitit	-	-	-	-	434,793	434,793
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2014</b>	<b>2,544,398</b>	<b>79,746</b>	<b>3,681</b>	<b>3,219,601</b>	<b>809,399</b>	<b>6,656,825</b>
Gjendja me 1 janar 2014	2,544,398	79,746	3,681	3,219,601	809,399	6,656,825
Shtesa nga HEC	-	729	-	-	-	729
Rezultati i vitit	-	-	-	-	533,045	533,045
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2015</b>	<b>2,544,398</b>	<b>80,475</b>	<b>3,681</b>	<b>3,219,601</b>	<b>1,342,445</b>	<b>7,190,599</b>

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

## Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve të Parasë

	31 dhjetor 2015 mijë lekë	31 dhjetor 2014 mijë lekë
<b>Aktivite Operative</b>		
Humbja e vitit para tatimit	626,102	537,831
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimi	269,562	262,482
Renie ne vlere e inventarit		32,373
(Rimarrje) /rënie në vlerë e llogarive të arkëtueshme	(170,678)	84,373
Rënie në vlerë e emrit të mirë	260,753	260,753
Rimarrje/(Shpenzime) provizione te tjera	(3,178)	(10,784)
<b>Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet operative</b>	<b>982,562</b>	<b>1,167,028</b>
Rritje e llogarive të arkëtueshme	(663,248)	(357,043)
Pakesim / (Rritje) e inventarit	16,536	(70,209)
Rritje e furnitoreve	1,124,871	162,113
(Pakesim) /Rritje i detyrime te tjera	(15,863)	16,927
Pakesim i detyrime ndaj shtetit	(13,757)	(81,084)
Rritje e detyrime ndaj personelit	63,504	30,610
Tatim fitimi i paguar	(209,397)	(168,309)
<b>Kapitali Qarkullues</b>	<b>302,647</b>	<b>(466,994)</b>
<b>Mjete monetare që rrjedhin nga aktivitetet operative</b>	<b>1,285,208</b>	<b>700,034</b>
<b>Aktivite Investuese</b>		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(592,433)	(558,337)
<b>Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese</b>	<b>(592,433)</b>	<b>(558,337)</b>
<b>Aktivite financuese</b>		
Pagesa për huatë e institucioneve të tjera	(285,812)	(130,371)
Pagesa nga detyrimet e Granteve	(15,282)	(15,755)
<b>Flukset monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financuese</b>	<b>(301,093)</b>	<b>(146,126)</b>
<b>Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre</b>	<b>385,326</b>	<b>(4,429)</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	11,590	16,019
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit</b>	<b>396,917</b>	<b>11,590</b>

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

# Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

## **1 Informacion i përgjithshëm mbi Grupin Ujësjetës Kanalizime Sh.a dhe Shoqëritë e Kontrolluara prej tij ("Grupi" ose "UKT")**

### **1.1 Informacioni ligjor**

Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a ("Shoqëria") është krijuar me vendimin e gjykatës Tiranë nr.24875, datë 28.12.2000, bazuar në vendimin e aksionerit të vetëm, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për Krijim e Ndërmarrjes Ujësjetës Kanalizime Qytet sh.a., me kapital aksioner prej 2,008,900,000 lekë, i përbërë nga 2,008,900 aksione me vlerë nominale 1000 lekë /aksioni, tërësisht i paguar me kontribute në natyrë.

Shoqëria operon në aktivitetin e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitjes së tij. Shoqëria gjithashtu përfshihet në mirëmbajtjen e sistemit (edhe) e furnizimit me ujë të pijshëm, prodhim dhe/ose blerje e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve, shërbimin e grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura dhe shitjen e tij, mirëmbajtjen e sistemeve të ujrave të ndotura, si dhe implemtent të pastrimit të tyre.

Krijimi i saj është realizuar në bazë të urdhërit nr.46, datë 05.12.2000 të Ministrisë së Ekonomisë dhe Privatizimit, vendim i marrë në vijim të Nenit 2, të ligjit nr.8237, datë 01.09.1997: "Për disa ndryshime të Ligjit nr.7926, datë 20.04.1995". "Për transformimin e ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregëtare, i ndryshuar me dekretin nr.1195, datë 14.08.1995, ligji nr.8099, datë 28.03.1996, me dekretin 1631, datë 1.11.1996 dhe ligjin 8158, datë 7.11.1996, ligjin nr.8158, datë 7.11.1996", dhe VKM nr.58, datë 24.2.2000 "Për kriteret e vlerësimit të Kapitalit themeltar të Shoqërive Shtetërore që do të krijohen nga shndërrimi i Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregëtare".

Me vendimin nr.228, datë 04.06.2003, aksioneri i vetëm (Ministria e Ekonomisë) vendosi bashkimin me përthithje të Ndërmarrjes Ujësjetës Kanalizime Qytet, me Ndërmarrjen e Ujësjetës Pshat, krijuar me vendim gjykate nr.27377, datë 12.03.2002, vendim i regjistruar në Gjykatën e Tiranës, nr.24875/2, datë 17.07.2003. Pas këtij bashkimi, Kapitali i Shoqërisë u bë 2,561,571,000 lekë, nr i aksioneve 2,561,571 me vlerë nominale 1,000 lekë / aksioni.

Në 24 Janar 2007, me numrin e cështjes CN-109845-12-07, kuota që mbahet nga aksioneri i vetëm (Ministria e Ekonomisë) i Shoqërisë Ujësjetës Kanalizime Tiranë, u transferua në pronësi të njërive vendore të zonës së shërbimit që përbëhen nga 3 Bashki dhe 16 Komuna. Me datë 14/01/2010, numri i cështjes CN-354160-01-10, në lidhje me Kapitalin i Shoqërisë, u zvogëluar nga 2,561,571,000.00 lekë u bë 2,544,398,050.00 lekë. Ndërkaq numri i Aksioneve ishte 2,561,571.00 dhe u bë 2,544,398.00 lekë. Diferenca përfaqëson shtesë në vlerën e Kapitalit të paguar me numër cështjeje CN-15092-03-12 për depozitimin e ekstraktit të QRA, datë 27.02.2012.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Aksionerët në UKT ishin si vijojnë:

Aksioneri	Nr Aksioneve	%	Kontributi
Komuna Prezë	10 170	0.40	10 170 000
Komuna Farkë	33 074	1.30	33 074 000
Komuna Vaqar	25 441	1.00	25 441 000
Komuna Petrelë	20 365	0.80	20 365 000
Komuna Shëngjergjaj	10 170	0.40	10 170 000
Bashkia Kamëz	259 540	10.20	259 540 000
Komuna Zall Herr	30 535	1.20	30 535 000
Komuna Dajti	33 074	1.30	33 074 000
Komuna Bërzhitë	28 000	1.10	28 000 000
Bashkia Tiranë	1 844 697	72.50	1 844 697 000
Bashkia Vorë	35 634	1.40	35 634 000
Komuna Baldushk	15 269	0.60	15 269 000
Komuna Paskuqan	111 946	4.40	111 946 000
Komuna Kashar	58 510	2.30	58 510 000
Komuna Bërzhite	17 803	0.70	17 803 000
Komuna Krrabë	10 170	0.40	10 170 000
<b>Totali</b>	<b>2 544 398</b>	<b>100</b>	<b>2 544 398 000</b>

Me datë 04.09.2015, numri i cështjes CN-243826-09-15, ka pësuar ndryshimet e mëposhtme tek Ortakët Juridik dhe Aksionerët në UKT janë si vijojnë:

Aksioneri	Nr Aksioneve	%	Kontributi
Bashkia Tiranë	2 099 108	82.50	2 099 108 000
Bashkia Kamëz	371 486	14.60	371 486 000
Bashkia Vorë	73 804	2.90	73 804 000
<b>Totali</b>	<b>2 544 398</b>	<b>100</b>	<b>2 544 398 000</b>

Adresa ligjore UKT sh.a është te Rruga 5 Maji, pranë Medresesë, Tiranë. Shoqëria është subjekti i regjistruar në TVSH dhe është pajisur me NIPT J620050020. Me 31 dhjetor 2015, Shoqëria ka 870 punonjës kundrejt 1170 punonjës me 31 dhjetor 2014.



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

## 1.2 Informacion mbi veprimtarinë

Në vitin 1939, me përfundimin e qëndrës së Tiranës (ndërtimin e Ministrive dhe shëtitores "Dëshmorët e Kombit me rrjetin që furnizon objektet e ndërtuara.

Për administrimin e Impiantit dhe rrjetit shpërndarës, u krijua Shoqëria e Ujësjetillës Tiranë me vartësi nga Ministria e Punëve Botore. Ky administrim ka vazhduar edhe pas 1944-ës, të cilën e vërtetojnë lejet nga Shoqëria për ndërtimin e çezmave publike në qytetin e Tiranës. Në vitin 1951, qytetit të Tiranës, përveç Impiantit Brar, iu shtuan edhe Burimet e Selitës, të cilat, pasi përpunohen në Hidrocentralin Lana-Bregas, shpërndahen në depot e Tiranës. Me rritjen e numrit të konsumatorëve shtohen kërkesat për ujë. Në vitin 1964, Tiranës i janë shtuar burime të tjera: Burimi i Bovillës me prurje  $Q=140-420$  l/sek dhe Burimet e Shën Mërisë me prurje  $Q=600$  l/sek.

Në vitin 1988, Tiranës i shtohen burime të reja me ngritje mekanike Bërxull dhe Pishinat. Me rritjen e kërkesave, po në vitin 1988, me fonde të përbashkëta nga Ministria e Bujqësisë dhe Komunale, u krye studimi për ndërtimin e Digës së Bovillës me kapacitet 80 milion m<sup>3</sup>/ujë dhe aftësi përpunuese 40 milion m<sup>3</sup>/ujë. Diga e Bovillës përfundoi në vitin 1999, e në funksion të saj u ndërtua Impianti i Pastrimit të Ujit, me kapacitet përpunues prej 1800 l/sek. Impianti i Pastrimit të Ujit është vënë në punë në vitin 2000.

a. Informacion mbi produktet kryesore dhe shërbimet e UKT;

b. Liçensa e Shoqërisë është rinovuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator i Ujit me nr.21, me vendim nr.28, datë 01.07.2013, mbas një procesi monitorimi dhe vlerësimi të përmbushjes së të gjitha kërkesave për këtë liçencë nga Enti Rregullator i Ujit, në bazë të ligjit nr.8102, datë 28.03.1996 "Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura."

Veprimtaritë përkatëse të kualifikuara në kategori janë:

- Kategorija A: për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- Kategorija B: për përpunimin e ujit për konsum publik;
- Kategorija C: për largimin e ujrave të ndotura.

Në zonat e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Tiranë, Kamëz, Vorë, Komuna Prezë, Farkë, Petrelë, Krrabë, Dajt, Bërxull, Baldushk, Vaqar, Zall – Herr, Pezë, Kashar, Ndroq dhe Paskuqan.

UKT ofron shërbimet e mëposhtme:

- i) shpërndarjen e ujit të pijshëm;
- ii) installimin e matësave;
- iii) instalimin e pikëlidhjeve me rrjetin;
- iv) azhurnimin e rrjetit;
- v) largim e ujrave të ndotura;
- vi) shirjen e ujit me bote;
- vii) furnizimin me ujë të HEC Lanabregas: etj.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

### **1.3 Informacioni mbi përthithjen e Shoqërisë HEC Lanabregas sh.a në Ujësjetllës Kanalizime sh.a**

Shoqëria "HEC Lanabregas" Sh.a u krijua si Shoqëri Anonime Shtetërore në 31.08.2011 dhe u regjistrua në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tirane, në 07.09.2011 si rezultat i një operacioni spin – off të aktiveve të prodhimit të energjisë elektrike të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare sh.a të përdorura prej saj, në vendndodhjen Lanabregas, Komuna Dajt, Tiranë.

Themeluesi i HEC Lanabregas Sh.a si aksioner i vetem ishte Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës. Veprimtaria e HEC Lanabregas rregullohej sipas dispozitave përkatëse të ligjit 9901, datë 14.04.2010, "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregëtare" si dhe nga statusi dhe legjislacioni Shqiptar në fuqi.

*Objekti i veprimtarisë: Prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike.*

Në vijim të kontratës Nr. 1588 Rep, Nr 320 Kol, datë 08.05.2012 "Për blerjen e Aksioneve të HEC Lanabregas sh.a", ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregëtare". UKT sha u shndërrua në zotëruesin me masën 100% të Kapitalit të Shoqërisë Hec Lanabregas sh.a.

Me datë 15.10.2012 u diskutua nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a Tiranë dhe u vendos të miratojë Projektin e Marrëveshjes së Bashkimit me përputhje të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a dhe HEC Lanabregas sh.a ku Shoqëria UKT sh.a është shoqëria përthithëse dhe shoqëria HEC Lanabregas sh.a është shoqëria e përthithur.

Asambleja e Aksionarëve të UKT sh.a, me datë 16.01.2013, pasi shqyrtoi transaksionin, vendosi të aprovojë Marrëveshjen e Bashkimit me përthithje të Shoqërive Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a dhe HEC Lanabregas sh.a ku Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a ishte shoqëria përthithëse dhe Shoqëria HEC Lanabregas sh.a ishte shoqëria e përthithur. Ky operacion sipas Marrëveshjes u realizua mbi të dhënat e datës 30 shtator 2012.

Ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, përthithja e rezultateve të HEC Sh.a nga UKT u përfundua me datë 07.02.2013 me numer cështje CN-998395-01-13, me nr.1 të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, datë 16.01.2013.

### **1.4 Informacioni mbi krijimin dhe transferimin e Shoqërisë HEC Lanabregas sh.a**

Me datë 18.07.2014 është regjistruar Shoqëria HEC Lanabregas Sh.a pranë QKR-së me NIPT L41918001E dhe aksioner 100% UKT sh.a, me një kapital prej 10,000,000 lekë sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr.13, datë 13.09.2013, me adresë Komuna Dajt, Hec Lanabregas me objekt të aktivitetit për prodhim të energjisë elektrike dhe shitjen e energjisë elektrike. HEC Lanabregas Sh.a mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Shoqëria HEC Lanabregas sh.a me NIPT L41918001E, deri në marrjen e licensës së shitjes së energjisë elektrike në emër të saj, nënshkroi një kontratë porosie me UKT sh.a me Numër Protokollit 11658, datë 21.07.2014, në të cilën ajo kishte të drejtë të shfrytëzonte, përdorte dhe të mirëmbante asetet e UKT-së me qëllim për prodhimin e energjisë elektrike. Gjithashtu, është nënshkruar kontrata e hapërdorimit midis dy Shoqërive me Numër Protokollit 19522, datë 10.12.2014 që i shërben të njëjtit qëllim.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

## Transferimi i HEC Lanabregas

Sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve nr.22, datë 14.09.2015, u miratua raporti i ekspertëve kontabel për transferimin e veprimtarisë ekonomike të prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike nga shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a tek shoqëria HEC Lanabregas Sh.a dhe zmadhimin e kapitalit të shoqërisë HEC Lanabregas Sh.a si rezultat i këtij transferimi. Kapitali Aksioner i Shoqërisë HEC Lanabregas Sh.a u shtua në vlerën e aktiveve të transferuara për 182,397,676 lekë (vlerë neto).

## 2 Bazat e përgatitjes

### 2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit UKT Sh.a janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Kuadri kontabel i aplikuar është i bazuar në politikat kontabel të listuara në shënimin 3. Me poshtë paraqiten parimet kryesore të politikave kontabel të aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Shoqëria mëmë UKT Sh.a përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF për Grupin UKT Sh.a, i cili përfshin UKT Sh.a dhe HEC Lanabregas Sh.a. Në pasqyrat financiare të konsoliduara, Shoqëritë e Kontrolluara, në të cilat Grupi kontrollon në mënyre direkte ose jodirekte më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose zoteron të drejtën për të ushtruar kontroll mbi aktivitetet e tyre, konsolidohen plotësisht.

## 3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabel

Politikat themelore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara janë të paraqitura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitura, nëse nuk shprehet ndryshe.

### 3.2 Ndryshimet në politikat kontabel

- (i) Standardet e reja dhe ato të ndryshuara që janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2015

Disa standarde të reja dhe të rishikuara janë efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas 1 janarit 2015. Informacioni në lidhje me këto standarde është paraqitur si më poshtë.

**Përshtatja e hershme e 'Skemës me përfitime të përcaktuara: Kontributet e punonjësve (Ndryshime në SNK 19)**

Institucioni ka adoptuar më herët 'Skemën me përfitime të përcaktuara: Kontributet e punonjësve (Ndryshimet në SNK 19)'. Këto ndryshime janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Korrik 2014 dhe:

- qartësojë kërkesat e SNK 19 në lidhje me kontributet e punonjësve ose palëve të treta;



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

- prezantojnë një praktikë të dobishme kur kontributet janë të pavarura nga numri i viteve të shërbimit mund të trajtohen si një reduktim i kostove të shërbimit në periudhën në të cilën shërbimi është ofruar.

Grupi ka aplikuar këtë praktikë në politikat e saj kontabël. Ky trajtim është në përputhje me praktikat e mëparshme të Grupit para Ndryshimeve në SNK 19. Prandaj, aplikimi fillestar i ndryshimeve nuk ka efekt në pasqyrat financiare individuale të shoqërisë.

Ndryshimet e tjera në SNRF-të që u bënë të detyrueshme në fuqi në vitin 2015 nuk kanë ndikim material në rezultatet apo pozicionin financiar të Grupit . Prandaj, Grupi nuk ka bërë asnjë ndryshim në politikat e tij kontabël në vitin 2015

**(ii) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e bëra në lidhje me standardet që nuk janë efektive dhe që nuk janë adoptuar më përpara nga ana e shoqërisë**

Në datën e autorizimit të pasqyrave financiare të konsoliduara, disa standarde të reja, ndryshime e standardeve ekzistuese ishin publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) por që nuk janë bërë ende efektive dhe nuk kanë qenë të adoptuara më parë nga Grupi. Informacion në lidhje me ato standarde që priten të jenë të rëndësishme për pasqyrat financiare të Grupit është dhënë më poshtë.

Drejtimi i Grupit parashikon që të gjitha deklaratimet do të adoptohen në politikat kontabël të organizatës në momentin që këto deklaratime do të bëhen efektive. Standardet, adoptimet dhe interpretimet e reja që janë nuk janë adoptuar apo listuar më poshtë nuk pritet që të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të shoqërisë.



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

#### **SNRF 9 'Instrumentat Financiare' (2014)**

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) ka prezantuar së fundmi SNRF 9 "Instrumentet financiare" (2014), që përfaqëson përfundimin e projektit të tij për të zëvendësuar SNK 39 "Instrumentat Financiarë: Njohja dhe matja". Standardi i ri prezanton ndryshimet të mëdha të udhëzimeve të SNK 39 mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe paraqet një model të ri 'humbje e prituri krediti' për zhvlerësimin e aktiveve financiare. SNRF 9 gjithashtu ofron udhëzime të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Drejtimi ka filluar të vlerësojë ndikimin e SNRF 9, por nuk është ende në gjendje për të dhënë informacion sasior. Në këtë fazë fushat kryesore të ndikimit të pritshëm janë si më poshtë:

- **klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare të Grupit** do të duhet të shqyrtohen në bazë të kriterëve të reja të cilat i konsideron fluksin monetar kontraktuale të aktiveve dhe modelin e biznesit në të cilën ato janë menaxhuar
- do të jetë më e mundur për të matur investimet e kapitalit me kosto minus zhvlerësim dhe të gjitha këto investime do të maten me vlerën e drejtë. Ndryshimet në vlerën e drejtë do të paraqiten në fitim ose humbje, përveç rasteve kur Grupi bën një përcaktim të pakthyeshëm për t'i paraqitur ato në të ardhura të tjera përmbledhëse.
- nëse Grupi zgjedh opsionin e vlerës së drejtë për pasivet financiare të caktuara, lëvizjet e vlerës së drejtë do të paraqiten në të ardhura të tjera të përgjithshme në masën që këto ndryshime kanë të bëjnë me rrezikun e kredisë së vetë Grupit.

SNRF 9 është në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018

#### **SNRF 15 'Të ardhurat nga Kontratat me Klientët'**

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të ardhurave, duke zëvendësuar SNK 18 'Të ardhurat', SNK 11 "Kontratat e ndërtimit", dhe disa Interpretimet të tjera në lidhje më të ardhurat. Standardi i ri krijon një model për njohjen e të ardhurave të bazuar në kontroll dhe jep udhëzime shtesë në shumë fusha që nuk mbulohen në detaje nga SNRF-të ekzistuese, duke përfshirë se si të trajtohen marrëveshjet me detyrimet e shumta të performancës, çmimet ndryshueshme, të drejtat e rimbursimit të klientëve, opsionin për riblerje nga furnizuesi, dhe të tjera kompleksitete të zakonshme.

SNRF 15 është efektive për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 janar 2018. Drejtimi i Grupit nuk ka vlerësuar ende ndikimin e SNRF 15 mbi këto pasqyra financiare.

#### **Ndryshime në SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta**

Këto ndryshime ofrojnë udhëzime mbi kontabilizimin për blerjen e interesave në operacionet e përbashkëta të cilat përbëjnë një biznes. Ndryshimet kërkojnë që të gjitha transaksionet e tilla të kontabilizohen duke përdorur parimet e kontabilitetit të kombinimit të bizneseve sipas SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" dhe SNRF-të e tjera, përveç kur ato parime janë në kundërshtim me SNRF 11. Blerjet e interesave në sipërmarrjet e përbashkëta nuk ndikohen nga ky udhëzim të ri.

Grupi nuk ka bërë deri më sot ndonjë investim në një marrëveshje të përbashkët, në të cilën Grupi të ketë të drejta për një pjesë të aktiveve neto të marrëveshjes në vend të të drejtave të drejtpërdrejta mbi aktivet dhe detyrimet. Prandaj, në qoftë se adoptohen sot, këto ndryshime nuk do të kenë ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare. Ndryshimet janë efektive për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janar 2016.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

### 3.2 Baza për konsolidimin

Pasqyrat financiare të Grupit konsolidojnë ato të shoqërisë mëmë dhe të shoqërisë së kontrolluar të saj më 31 dhjetor 2015. Shoqëria e Kontrolluar ka një datë raportimi më 31 dhjetor 2015.

Të gjitha transaksionet dhe balancat ndërmjet të shoqërive të Grupit janë eliminuar në konsolidim, duke përfshirë fitimet e përcaktuara dhe humbjet nga transaksionet në ndërmjet shoqërive të Grupit. Në rastet kur humbjet e përcaktuara në shitjet e aseteve brenda grupit janë stornuar në konsolidim, aktivi është testuar edhe për zhvlerësim nga prespektiva e grupit. Shumat e raportuara në pasqyrat financiare të Shoqërive të Kontrolluara janë përshtatur aty ku është e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me politikat kontabël të miratuara nga Grupi.

Fitimi ose humbja dhe të ardhura të tjera përmbledhëse e Shoqërive të Kontrolluara të blera apo të shitura gjatë vitit njihen nga data efektive e blerjes, ose deri në datën efektive të shitjes, sipas rastit.

Grupi i atribuon të ardhurat totale gjithëpërfshirëse apo humbjen e filialeve ndërmjet pronarëve të Shoqërisë mëmë dhe interesave jo-kontrolluese në bazë të interesave të tyre përkatëse pronësore.

### 3.2 Kombinimet e biznesit

Grupi aplikon metodën e blerjes në kontabilitetin për kombinimet e biznesit. Pagesat e transferuara nga Grupi për të marrë kontrollin e një Shoqërie të Kontrolluar llogariten si shuma e vlerës së drejte në datën blerjes efektive të aktive të transferuar, detyrimeve të lindura dhe interesat e kapitalit të emetuara nga Grupi, si dhe vlerën e drejtë të çdo aktivi ose detyrimi të kushtezuar të rregulluar me marrëveshje. Kostot e blerjes njihen në rezultat në periudhën kur ndodhin. Aktivitetet e blera dhe detyrimet e përlogaritura maten në përgjithësi me vlerën e tyre të drejtë në datën e blerjes efektive.

### 3.3 Monedha të Huaja

Transaksionet në monedhë të huaj janë përkthyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e ditës në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet të shprehura në valutë të huaj në datën e raportimit janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në atë datë.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të emetuara në monedhë të huaj që janë të matur me vlerën e drejtë janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Diferenca nga kurset e këmbimit të ndodhura gjatë përkthimit njihen në fitim ose humbje.

Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura për monedhat e huaja kryesore në 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë paraqitur në Lekë Shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha funksionale. Shumat janë rumbullakosur në mijëshen më të afërt (përveç rasteve kur është shprehur ndryshe).

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Dollari Amerikan (USD)	125.79	115.23
Njësia monetare e Bashkimit Europian (EUR)	137.28	140.14

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2016  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

### 3.4 Emri i mirë

Emri i mirë përfaqëson përfitimet ekonomike në të ardhmen që rrjedhin nga një kombinim biznesi që nuk janë identifikuar individualisht dhe të njihen veçmas. Emri i mirë mbahet me kosto minus humbjet nga rënia në vlerë të akumuluar.

Për qëllime të testit të vlerës së emrit të mirë, ai alokohet në Njësinë Gjeneruese të Fitimeve të identifikuar dhe që priten të përfitojë nga sinergjitë e kombinimit të bizneseve. Njësia e Gjenerimit të Fitimeve për të cilën është alokuar emri i mirë, përfaqëson nivelin më të ulët brenda Shoqërisë mbi të cilën monitorohet emri i mirë. Emri i mirë monitorohet në nivel të raporteve segmentare.

Testimi për zhvlerësimin e emrit të mirë realizohet çdo vit nga Shoqëria. Vlera e mbartur në kontabilitet krahasohet me vlerën e rikuperueshme. Në rast se diferenca midis vlerës së rikuperueshme dhe vlerës së mbartur në kontabilitet është negative, atëherë humbja kalohet në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave gjithëpërfshirëse. Kjo shumë njihet menjëherë dhe nuk rimerret sërish.

### 3.5 Aktivët afatgjata materiale dhe aktive të tjera afatgjata

#### (i) Njohja dhe matja

Aktivët afat-gjata materiale janë aktive të trupëzuara të cilat mbahen për përdorim në ofrimin e shërbimeve ose për qëllime administrative.

Zërat e aktiveve afat-gjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga zhvlerësimi. Kostoja historike përfshin shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e këtyre elementeve.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shumat e marra me vlerën e mbetur, dhe duke përfshirë diferencën në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse të të ardhurave në zërin 'Fitime/(humbje) të tjera'.

#### (ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën e mbetur të zërit përkatës nëse është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin në fjalë do të merren nga Grupi dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen në të ardhura ose shpenzime.

#### (iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime me metodën lineare mbi jetën e dobishme të aktivit për ndërtesat, kompjuterat, furniturat dhe pajisje edhe mjetet e transportit. Aktivët e marra me qira amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis periudhës së qiramarrjes dhe jetës së tyre të dobishme. Toka nuk amortizohet.

Vlera e rikuperueshme dhe jetët e dobishme rishikohen, dhe nëse është e nevojshme bëhen rregullimet përkatëse, në çdo datë bilanci.

Ndërtesat, makineritë dhe pajisjet e lidhura me aktivitetin e Grupit, amortizohen bazuar në jetëgjatësinë e aktivit. Në këto raste për amortizimin e tyre përdoret metoda lineare. Baza e përlogaritjes përfshin shumën fillestare të "makineri dhe pajisje" dhe duke zbritur vlerën e rikuperueshme të aktivit.



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Ndërtesat, makineritë dhe pajisjet e tjera amortizohen me metodën lineare në bazë të jetës së dobishme të tyre, që zakonisht përlogaritet mbi jetëgjatësinë e supozuar të aktivit. Jetëgjatësia e aplikuar e aktivit të UKT-së është përcaktuar me Vendimin nr.16, datë 23.12.2013 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve i cili paraqitet si vijon:

Kategoria	Nr. i viteve
Ndërtesa dhe struktura të tjera ndërtimore	5 - 100
Rrjeti Ujësjellës	15 - 70
Rrjeti Kanalizime	30 -70
Makineri dhe pajisje	4 - 45
Mjete transporti	5 - 13
Pajisje informatike dhe Inventari ekonomik	5
Aktive Afatgjata jo-materiale	5

Vlerësimi i jetës së aktiveve është bërë duke parë nivelin e lartë të konsumimit dhe dëmtimeve në asetet e Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

*(iv) Rënia në vlerë*

Vlera e mbartur e ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve kryesore të Grupit janë testuar çdo vit për rënien e mundshme në vlerë, atëherë kur ngjarjet apo kushtet e gjëndjes financiare tregojnë që shumata e mbartur e këtyre aktiveve nuk mund të rikuperohet.

Në rast se për aktivet identifikohet fakti që mbartin një rënie të vlerës së tyre, atëherë shumata e mbartur në kontabilitet zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme. Shumata e rikuperueshme përfaqësohet nga shumata më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim, ku kjo e fundit është llogaritur si vlera e skontuar e flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të rregulluara nga faktorët e riskut që mbartin.

Për këtë arsye grupohen sipas aftësisë së tyre për të gjeneruar flukse hyrëse të parasë bazuar në faktin që këto aktive janë të identifikueshme dhe që gjenerojnë flukse të rëndësishme të mjeteve monetare.

Vlerësimet e flukseve të ardhshme të parasë të përdorur, me vlerën e rënë të aktiveve të lidhura me prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve të Grupit, kryhen duke përdorur vlerësimin e riskut në lidhje me prodhimin dhe performancën e tyre.

Zbritja në vlerë e aktiveve, përveç emrit të mirë, aplikohet sa herë që ngjarjet të cilat kanë çuar në këtë rënie të vlerës ndryshojnë. Shtimet apo pakësimet e rënies në vlerë, raportohen së bashku me zhvlerësimin, harxhimin dhe amortizimin.

### **3.6 Aktivët afat-gjata jomateriale**

Aktivët afat-gjata jomateriale, të cilat kanë një jetë të dobishme të kufizuar, vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimet e akumuluar. Norma e amortizimit është 10%-20% bazuar në koston e aktivit. Në aktivët afatgjata jomateriale të Grupit përfshihet edhe emri i mirë (shënimi 3, paragrafi 3.5) i njohur në momentin e kombimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë mëmë UKT Sh.a me pasqyrat të Shoqërisë HEC Lanabregas Sh.a në momentin e përthithjes (shënimi 1, paragrafi 1.3) së HEC Lanabregas nga UKT Sh.a.



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

#### *Shpenzimet e mëpasshme*

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse shpenzimi tregon përfitimet e arteston teston dhe ekonomike të trupëzuara në aktivin me të cilin ka të bëjë shpenzimi. Të gjitha shpenzimet, duke përfshirë shpenzime për emrin e mirë të gjeneruar nga Grupi apo markat, njihen në të ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

#### *Amortizimi*

Amortizimi njihet në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse të të ardhurave bazuar në vlerën e mbetur duke përdorur normat fiskale për amortizimin e aktiveve të patrupëzuara, një muaj pas blerjes së aktivit.

Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet, dhe bëhen rregullimet e nevojshme, në çdo datë bilanci. Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shitjet me vlerën e mbetur dhe diferencat përfshihen në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse të të ardhurave

### **3.7 Inventari**

Inventari vlerësohet me vlerën më të vogël ndërmjet kostos historike dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.

### **3.8 Instrumentet financiare**

Grupi klasifikon instrumentet financiare të saj sipas kategorive të mëposhtme në kredi dhe të tjera të arkëtueshme dhe aktive financiare të mbajtur deri në maturim dhe aktive financiare të vlefshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin aktivet dhe detyrimet financiare janë blerë. Drejtimi përcakton klasifikimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare në njohjen fillestare dhe kur është nevojshme ri-vlerëson këtë përcaktim në çdo datë raportimi.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

### 3.8.1 Aktivet financiare

#### *Kredi dhe të tjera të arkëtueshme*

Kredi dhe të tjera të arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në tregje aktive përveç atyre aktiveve që Grupi synon ti shesë brenda një periudhe afatshkurtër ose i ka përcaktuar si aktive me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje. Kreditë dhe të drejtat e tjera njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provigjionin për zhvlerësim. Provigjioni për zhvlerësimin e kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme krijohet kur ka një evidencë objektive që Grupi nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Të drejtat e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit që vijnë nga mbajtësit e policave të sigurimit gjithashtu klasifikohen në këtë kategori dhe rishikohen për zhvlerësim si pjesë e rishikimit përzhvlerësim të kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme.

#### *Investime financiare të mbajtura deri në maturim*

Investime financiare të mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme përveç atyre që përmbushin përkufizimin e kredive dhe të tjera të arkëtueshme dhe për të cilat Grupi ka qëllimin dhe mundësinë për ti mbajtur ato deri në maturim. Këto aktive njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provigjionin për zhvlerësim, nëse ka. Një provigjion për zhvlerësimin e instrumenteve të borxhit të mbajtur deri në maturim krijohet nëse ka një evidencë objektive që Grupi nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Investime financiare të mbajtura deri në maturim përfshijnë bono thesari të emetuara nga Banka e Shqipërisë.

#### *Njohja dhe çregjistrimi*

Blerjet dhe shitjet e investimeve financiare njihen në datën e tregtimit e cila është data kur Grupi angazhohet të blejë apo të shesë instrumentin. Aktivet financiare njihen në fillim me vlerë të drejtë plus, koston e transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e tyre në rastin e të gjithë aktiveve financiare që nuk mbahen me vlerë të drejtëpërmes fitimit ose humbjes. Aktivet financiare të mbajtura me vlerë të drejtëpërmes fitimit ose humbjes njihen fillimisht me vlerë të drejtë, dhe koston e transaksionit njihen në të ardhura ose shpenzime.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale për arkëtime nga instrumentet financiare kanë skaduar ose janë transferuar dhe kur Grupi transferon të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë.

#### *Matja e mëpasshme*

Aktivitetet financiare të vlefshme për shitje dhe aktivitetet financiare me vlerë të drejtëpërmes fitimit ose humbjes mbahen me vlerë të drejte. Kreditë dhe të drejtat e tjera të arkëtueshme dhe aktivitetet e tjera të mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Kompesimi i instrumenteve financiare*

Aktivitetet dhe detyrimet financiare raportohen të kompesuara në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjërish të zbatueshme për të netuar shumat e njohura dhe ka një qëllim për të mbajtur ato mbi bazë neto, ose të njohësh aktivin dhe të shlyesh detyrimin në të njëjtën kohë.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

#### Investime në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë janë instrumente borxhi për të cilat Grupi ka qëllimin dhe aftësinë që të mbaje deri në maturim dhe të klasifikojë si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet, të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktuara dhe të cilat mbahen deri në maturim maten në vijim me koston e amortizuar minus provigjionin përzhvlerësim. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë në konsideratë çdo zbritje ose prim në blerje.

#### Instrumente kapitali

Instrumentet e kapitalit janë aktive financiare të cilat nuk kanë një çmim tregu në një treg aktiv dhe vlera e drejte e tyre nuk mund të matet në mënyrë të besueshme prandaj maten me kosto.

#### Depozita me afat

Depozitat me afat janë klasifikuar si kredi dhe të drejta dhe mbahen me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

#### Llogarite të arketueshme

Llogarite të arketueshme nga aktiviteti krzesor dhe të arketueshme të tjera paraqiten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

#### Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

Për qëllimin e përgatitjes së pasqyrës së konsoliduar të pozicionit financiar dhe pasqyrës së konsoliduar të flukseve të parasë, mjetet monetare përfshijnë arkën dhe gjendjet e llogarive bankare me maturitet më pak se 3 muaj dhe pa risk të rëndësishëm të ndryshimit në vlerë.

### 3.8.2 Detyrimet financiare

Grupi i klasifikon detyrimet financiare në kategoritë vijuese: llogari të pagueshme dhe detyrime financiare.

#### Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektív.

#### Huamarrja

Huamarrja njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga koston e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektív. Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se eniteti ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

#### Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes të cilat lehtësisht janë të lidhura me ndërtimin, prodhimin apo blerjen e një aktivi, i cili ka nevojë për një kohë të gjatë për tu vënë në përdorim sipas qëllimit fillestar të përdorimit apo shitjes, i shtohen vlerës së aktivitetit, deri në momentin në të cilin aktivi është gati për përdorim. Të ardhurat nga investimet që fitohen gjatë një aktivi përkatës, i zbritet koston së kapitalizueshme të huamarrjes. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen pasqyrën e konsoliduar të ardhurave gjithëpërfshirëse.



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

### 3.8.3 Humbjet nga zhvlerësimi

Në çdo datë të pasqyrës së konsoliduar të pozicionit financiar, Grupi vlerëson nëse ka prova objektive që aktivet financiare ose një grup i aktiveve financiare është zhvlerësuar. Një aktiv financiar ose grup aktivesh financiare zhvlerësohet dhe humbjet nga zhvlerësimi njihen vetëm nëse ekzistojnë prova objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të një aktivi (një 'ngjarje humbje') dhe ngjarja e humbjes (ose ngjarjet) ka ndikim në flukset e ardhshme të vlerësuara të aktivit financiar ose të një grupi aktivesh financiare që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Dëshmi objektive që një aktiv financiar ose grup aktivesh është zhvlerësuar përfshin të dhëna të vëzhgueshme që vijnë në vëmendjen e Grupit në lidhje me ngjarjet e mëposhtme:

- a) Vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose të debitorit;
- b) Shkelja e kontratës, si vonesa në pagesa e penalitete;
- c) Mundësia që emetuesi ose debitori do të hyjë në proces falimentimi ose riorganizime të tjera financiare;
- d) Zhdukja e një tregu aktiv për aktivin financiar për shkak të vështirësive financiare, ose
- e) Të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare nga një grup i aktiveve financiare që nga njohja fillestare e tyre, megjithëse rënia ende nuk mund të identifikohet specifikisht me një aktiv financiar të Grupit, duke përfshirë:
  - Ndryshimet jo të favorshme në statusin e pagesës së emetuesit ose të debitorit në Grup, ose
  - Kushte ekonomike kombëtare apo lokale ekonomike që lidhen me mos pagesën e aktivit të Grupit.

Ne fillim, Grupi konsideron nëse ekzistojnë evidenca objektive individuale të zhvlerësimit për aktivet financiare dhe janë individualisht të konsiderueshme. Nëse Grupi përcakton se nuk ka evidenca objektive të zhvlerësimit për një aktiv financiar të testuar individualisht, i konsiderueshëm apo jo, e bashkon aktivin në një grup aktivesh financiare me rrezik krediti të njëjta dhe në mënyrë kolektive i teston për zhvlerësim. Aktivet që janë të testuara në mënyrë individuale dhe për të cilat një humbje nga zhvlerësimi ekziston ose vazhdon të njihet nuk bashkohen me aktivet e tjera që testohen në mënyrë kolektive.

Nëse ekziston evidencë objektive që një humbje nga zhvlerësimi është krijuar për huatë dhe të arkëtueshmet ose nga aktivet financiare të mbajtura deri në maturitet që mbahen me kosto të amortizuara, shuma e humbjes matet si diferencë midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuara (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë që kanë ndodhur) të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar. Vlera kontabël e aktivit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie rezerve, dhe shuma e zhvlerësimit njihet në fitim ose humbje.



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Nëse një investim i mbajtur deri në maturim ose një hua ka një normë të ndryshueshme të interesit, norma e skontimit për matjen e zhvlerësimit është norma aktuale efektive e interesit e përcaktuar sipas kontratës.

Si praktikë e njohur, Grupi mund të masë zhvlerësimin e një instrumenti financiar në bazë të vlerës së drejtë duke përdorur një çmim të vëzhguar të tregut.

Për qëllim të testimit kolektiv për zhvlerësim, aktivet financiare grupohen sipas karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kreditit (p.sh., në bazë të procesit të vlerësimit të Grupit që konsideron llojin e aktivitetit, industrinë, pozicionin gjeografik, statusin e pagesave, dhe faktorë të tjerë të lidhur).

Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme për grupe të tilla aktivesh duke qenë tregues i aftësisë së emeruesit për të paguar të gjitha shumat sipas kushteve kontraktuale të instrumentit të borxhit nën vlerësim.

Në goftë se në një periudhë të mëvonshme, shumata e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me ngjarje që ndodhin pasi zhvlerësimi ishte njohur (të tilla si përmirësimi i indeksit të kreditit), humbja e njohur më parë nga zhvlerësimi ndryshohet duke rregulluar llogarinë e rezervës. Shumata e ndryshimit njihet në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave gjithëpërfshirëse.

#### **3.8.4 Çrregjistrimi i instrumentave financiare**

Një aktiv financiar çrregjistrohet pjesërisht ose totalisht në rastin kur Grupi parashikon që nuk do gjenerohen më flukse parash nga ky aktiv dhe nuk e ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Kur kemi të bëjmë me mosarkëtim nga klienti, në rastin e llogarive të arkëtueshme, kryejmë një transferim të të gjitha risqeve dhe shpërblimeve që lidhen me pronësinë, atëherë kjo llogari klasifikohet për një transferim, duke bërë të mundur kështu që kjo llogari e arkëtueshme të jetë e vlefshme për çrregjistrim, duke supozuar që pagesa me vonesë përbën një risk të parëndësishëm. Një interpretim më i ngushtë i konceptit të "transferim thelbësor i rreziqeve dhe përfitimeve" mund të vendosë në pikëpyetje trajtimin kontabël që është adoptuar.

#### **3.9 Qiratë**

Përcaktimi nëse një marrëveshje është apo përmban një qira bazohet në thelbin ekonomik të marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi apo i disa aktiveve të veçanta dhe marrëveshja kalon të drejtën e përdorimit të aktivitetit.

Qiratë financiare të cilat transferojnë të gjitha rreziqet dhe përfitimet si pasojë e pronësisë së aktivitetit të marrë me qira, kapitalizohen në fillim të qirasë me vlerën e drejtë të pronës që merret me qira ose, kur është me e vogël, me vlerën aktuale të pagesave minimale të qirasë dhe përfshihen në aktive afatgjata materiale me detyrimin përkatës ndaj qiradhënësit të përfshirë në detyrime të qirasë financiare. Pagesat e qirasë ndahen midis shpenzimit financiar dhe reduktimit të detyrimit.

Aktivitetet e kapitalizuara amortizohen përgjatë më të shkurtrës midis jetës së tyre të dobishme dhe afatit të qirasë në rast se Grupi nuk përfiton pronësinë ligjore të aktivitetit në fund të periudhës së qirasë.

Pagesat e qirasë së zakonshme njihen në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar. Qiraja e pagueshme kontabilizohet në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë dhe përfshihet në 'Shpenzime të tjera operative'. Kur një qira e zakonshme përfundon para afatit të përcaktuar, çdo pagesë që është e

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

detyrueshme të bëhet qiradhënësit në formë penaliteti njihet si shpenzim në periudhën kur përfundimi ndodh.

### **3.10 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat në total përfshijnë të ardhurat nga shitjet neto dhe të ardhurat nga shërbimet të realizuara nga aktivitetet kryesore të Grupit, duke mos përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Pjesa më e madhe e shitjeve të Grupit gjenerohen nga shitja e shërbimeve të instalimit dhe mirëmbajtjes.

#### **(i) Të ardhurat nga shitha e shërbimeve dhe produkteve**

Në marrëveshjet për shitjen vetëm të shërbimeve, të ardhurat nga shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbimet e kanalizimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimit, bazuar në matjen e konsumit.

Të ardhurat nga shërbimet e mirëmbajtjes dhe azhurnimit, si dhe të shitjes së produkteve, të matësave, librezave të ujit, etj., njihen në momentin e realizimit të tyre.

Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose që do të arkëtohet. Në rastin kur një pagesë e shtyrë ka një ndikim të rëndësishëm në llogaritjen e vlerës së drejtë, do të llogaritet duke zbritur pagesat e ardhshme. Vlerësimi i arkëtimit të llogarive të arkëtueshme është i rëndësishëm për të përcaktuar nëse do të njihen ose jo të ardhurat ose shpenzimet. Si pjesë e procesit të njohjes së të ardhurave, vlerëson nëse do të rrjedhin përfitime ekonomike të lidhura me transaksionin. Nëse ka pasiguri në qoftë se do të hyjnë apo jo përfitime ekonomike, njohja e të ardhurave shtyhet dhe njihet mbi bazën monetare. Megjithatë, nëse ka pasiguri rreth mbledhjes së një shume, tashmë të përfshirë në të ardhurat, shumën e cila është e pamundur që të arkëtohet, njihet si shpenzim në zërin e kostos së mallrave të shitura.

Sipas vendimit numër 24 të Komisionit Kombëtar Rregullator të Ujit, datë 26.02.2013, "Për një shfuqizim në vendimin e KKR" dhe nr.29, datë 28.09.2011 "Për përcaktimin e llogaritjes së sasisë së ujrave të ndotura", vendosi që sasisë e ujrave të ndotura për çdo klient, do të llogariten me 100% të sasisë së ujit të konsumuar.

#### **(ii) Të ardhurat nga Interesi**

Të ardhurat nga interesi njihen në proporcion me kohën duke u bazuar në metodën e interesit efektiv. Kur një llogari e arkëtueshme është vështirë për t'u arkëtuar, Dega zvogëlon vlerën e mbartur deri në vlerën e recuperueshme, duke konsideruar që flukset e ardhshme të parashikuara, të zbritura me normën origjinale të interesit efektiv të instrumentit, dhe vazhdon të pakësojë zbritjen duke njohur të ardhurat nga interesi. Të ardhurat nga interesi në rastin e huave të cilat kanë rënie të vlerës njihen duke përdorur normën efektive origjinale të interesit.

#### **(iii) Të ardhura nga Grantet**

Qeveria e Shqipërisë dhe/ose Organizmat Ndërkombëtare, i ofrojnë Grupit grante në lidhje me realizimin e investimeve në infrastrukturën e rrjeteve. Fillimisht granti njihet si detyrim në pozicionin financiar, ndërsa që shumën e Grantit njihet të të ardhura me realizimin e investimit ose shpenzimeve për realizimin e tyre. Gjithashtu, Bashkitë dhe Komunitat mund të japin grante për kompensimin e çmimit të ujit apo shërbimeve të rregulluara, në këto raste të ardhurat njihen në proporcion me sasinë

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

e ujit apo shërbimeve të rregulluara që konsumohen. Në rastin ku ofrohen grante për mbulimin e shpenzimeve të UKT-së, ato njihen te të ardhura në masen e shpenzimit të realizuar.

### **3.11 Përfitimet e punonjësve**

#### *Përfitimet afat-shkurtra*

Grupi paguan për llogari të punonjësve të saj sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të llogaritura mbi pagën bruto, ashtu si edhe tatimin mbi të ardhurat personale të llogaritur gjithashtu mbi pagën bruto. Kontributet e mësipërme paguhen nga Grupi në një fond të administruar nga shteti, në përputhje me normat e përcaktuara me ligj gjatë vitit. Për më tepër, dietat për ushqim dhe transport dhe bonuset për pushime paguhen në përputhje me legjislacionin vendas. Këto shpenzime janë regjistruar në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në periudhën kur shpenzimet e pagave kanë ndodhur.

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve shoqërore njihen si shpenzim në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave kur ato ndodhin.

### **3.12 Tatimi mbi të ardhurat**

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Shpenzimi për tatimin mbi fitimin njihet në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse të të ardhurave përveç rastit kur ky shpenzim lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejtë në pasqyrën e konsoliduar të lëvizjeve në kapital, rast në të cilin shpenzimi njihet në këtë pasqyrë.

Tatimi aktual është tatimi që pritet për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm gjatë vitit, duke përdorur normat tatimore efektive në datën e raportimit apo ato të hyra në fuqi më vonë, dhe çdo sistemim ndaj tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e detyrimit, duke krijuar provigjion për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të mbetura për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit apo që do të hyjë më vonë në fuqi.

Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme dhe aktivet tatimore të shtyra njihen vetëm nëse është e mundur që në të ardhmen do të ketë përfitime fiskale kundrejt të cilave do të mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra reduktohen kur nuk ka mundësi që përfitimet e lidhura tatimore do të realizohen.

### **3.13 Provigjionet**

Provigjionet njihen kur Grupit ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin dhe kur një vlerësim i besueshëm i vlerës së detyrimit mund të bëhet. Nëse efekti është material, provigjionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhshme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë, dhe kur është e nevojshme trezikun specifik të detyrimit.



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

31 dhjetor 2015

Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin, provigjoni anulohet. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhme operative. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në kontabilitet.

### **3.14 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provigjion nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjionin, një detyrim njihet në datën e Pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

### **3.15 Transaksione me palët e lidhura**

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

### **3.16 Ngjarjet pas datës së raportimit**

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

## **4 Menaxhimi i rrezikut financiar**

### **4.1 Faktorët e rrezikut financiar**

Aktivitetet e Grupit e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare, që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të Grupit fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë.

Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut, si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kreditit, përdorimi i letrave me vlerë të përshatshme dhe investimi i likuiditetit të tepërt.



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

31 dhjetor 2015

Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

**4.2 Rreziku i tregut**

Rreziku i kursit të këmbimit

Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me Euro-n dhe Dollarin Amerikan. Grupi nuk përdor ndonjë instrument për tu mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi i Grupit është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të përshtatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e përditshme.

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj është si më poshtë:

2015	LEK	EUR	USD	Total
<b>Aktivët financiarë</b>				
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	396,405	3	509	396,917
Llogarite e arketueshme	2,716,829	-	-	2,716,829
<b>Totali aktive financiare</b>	<b>3,113,234</b>	<b>3</b>	<b>509</b>	<b>3,113,746</b>
]				
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perlogafitura	2,599,551	-	-	2,599,551
Detyrime ndaj personelit	77,897	-	-	77,897
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	189,850	-	-	189,850
Huamarrje afatshkurter	1,409,061	-	-	1,409,061
Huamarrje afatgjata	-	5,188,890	-	5,188,890
Grante	494,102	-	-	494,102
<b>Totali detyrime financiare</b>	<b>4,770,461</b>	<b>5,188,890</b>	<b>-</b>	<b>9,959,351</b>
<b>Pozicioni valutator neto</b>	<b>(1,657,227)</b>	<b>(5,188,887)</b>	<b>509</b>	<b>(6,845,605)</b>
<i>Analiza e ndjeshmerise</i>				
Ndjeshmëria nëse kursi i këmbimit rritet me 5 %		(259,444)		
Ndjeshmëria nëse kursi i këmbimit këmbimit zvogëlohet me 5 %		259,444		

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

2014	LEK	EUR	USD	Total
<b>Aktivët financiarë</b>				
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	11,120	4	466	11,590
Llogaritë e arketueshme	1,882,903	-	-	1,882,903
<b>Totali aktive financiare</b>	<b>1,894,024</b>	<b>4</b>	<b>466</b>	<b>1,894,494</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogaritë e pagueshem dhe detyrime te perfllogaritura	1,474,680	-	-	1,474,680
Detyrime ndaj personelit	22,926	-	-	22,926
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	309,591	-	-	309,591
Huamarrje afatshkurter	1,132,019	-	-	1,132,019
Huamarrje afatgjata		5,751,744	-	5,751,744
Grante	509,383	-	-	509,383
<b>Totali detyrime financiare</b>	<b>3,460,685</b>	<b>5,751,744</b>	<b>-</b>	<b>9,212,428</b>
<b>Pozicioni valutor neto</b>	<b>(1,566,661)</b>	<b>(5,751,740)</b>	<b>466</b>	<b>(7,317,934)</b>
<i>Analiza e ndjeshmërisë</i>				
Ndjeshmëria nëse kursi i këmbimit rritet me 5 %		(287,587)		
Ndjeshmëria nëse kursi i këmbimit këmbimit zvogëlohet me 5 %		287,587		

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit, dhe një korrelacion të vlerave të tyre për një 5% ndryshim në kurset e këmbimit. Përqindja është përcaktuar duke u bazuar në paqëndrueshmërinë e tregut në kursin e këmbimit në 12 muajt e mëparshëm.

#### 4.3 Risku i kredisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që një palë në instrumentin financiar, do të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër, duke mos arritur që të shlyhet detyrimi. Ekspozimi kryesor i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë lind për shkak të drejtave ndaj të tretëve. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj riskut të kredisë korrespondon me shumat e mbartura të aktiveve financiare në bilanc. Impakti i kompensimit të mundshëm të aktiveve dhe detyrimeve për të reduktuar ekspozimin ndaj riskut të kreditit, nuk është domethënës.

##### 4.3.1 Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit në veprimtarinë e saj të përditshme, sepse është e mundur që klientët e saj si dhe huamarrësit do të dështojnë të përmbushin detyrimet e tyre financiare. Strukturat e shoqërisë, nivelet e rrezikut të kredisë që merr përsipër, duke vendosur kufizime në sasinë e rrezikut të pranuar në lidhje me palë të treta dhe nëpërmjet diversifikimit të portofolit të

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015

Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

kredisë, janë metoda në menaxhimin e riskut. Kufijtë përta i përket nivelit të rrezikut të kredisë janë miratuar rregullisht nga drejtimi. Rreziqet e tilla janë të monitoruara në një bazë të ndryshueshme dhe i nënshtrohen një analizë vjetore ose dhe më të shpeshtë.

#### 4.3.2 Përqëndrimi i rrezikut të kredisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj përqëndrimeve të rrezikut të kredisë. Menaxhimimonitoron përqëndrimin e rrezikut të kredive, por has vështirësi në zbatimin e politikave më të mira të menaxhimit të ekspozimit të kompanisë ndaj rrezikut të tillë, duke diversifikuar portofolin e kredisë. Kjo ndodh për shkak se shoqëria është e detyruar të furnizojë me energji konsumatorin final.

Në rastin e shitjes së energjisë, rreziqet e kompanisë ekzistojnë në mospërbushjen e objektivave të saj, për një ose më shumë nga arsyet e mëposhtme: a) konsumatorët refuzojnë të paguajnë faturat e tyre, b) konsumatorët ndërhyjnë apo shkëpusin matësat, c) gjykatat nuk janë në gjëndje apo të gatshëm për të mbështetur shkeljet apo veprime të tjera ndaj konsumatorëve që nuk paguajnë.

Aktivitetet financiare të ekspozuara ndaj rrezikut të kredisë janë si më poshtë:

<b>Aktivitetet financiare</b>	
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	11,590
Llogaritë e arketueshme	1,882,903
<b>Totali aktive financiare</b>	<b>1,894,493</b>

UKT Sh.a testoi llogaritë e arkëtueshme të saj nëse ato kanë një rënie në vlerë në përputhje me politikat e brendshme të tij.

#### Metoda e vlerësimit

UKT evidenton llogaritë e arkëtueshme për efekt të vlerësimit të vlerës së drejtë si vijon:

#### Vlerësuar Individualisht

UKT fillimisht vlerëson nëse ka evidencë të humbjes së vlerës në rang individual dhe që kjo evidencë është materiale në grupin e aktivitetit financiar.

Nëse UKT identifikon si më sipër faktin që nuk ka evidencë për humbjet në vlerë, atëherë ajo e përfshin aktivin në një klasë të aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit dhe i vlerëson ata kolektivisht për rënien në vlerë. Aktivitetet që janë vlerësuar individualisht për rënien në vlerë dhe për të cilat humbja nga rënia në vlerë është, ose vazhdon të njihet, nuk është përfshirë në një vlerësim kolektiv për rënien në vlerë.

#### Vlerësuar Kolektivisht

Flukset e ardhshme monetare në një grup të aktiveve financiare që janë vlerësuar kolektivisht për rënien në vlerë, parashikohen në bazë të eksperiencës së humbjes historike për aktivitetet me karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit me ato në grup.

Në rastet kur UKT nuk ka një eksperiencë humbjeje specifike ose ka një eksperiencë të pamjaftueshme, atëherë përdoret eksperiencia e Shoqërive që operojnë në të njëjtin ueg.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Humbjet janë rregulluar në bazë të të dhënave aktuale të vëzhguara për të reflektuar efektet e kushteve aktuale të cilat nuk kanë ndikuar në periudhën në të cilën është bazuar eksperiencia e humbjes historike dhe të mënjanojë efektet e kushteve në periudhën historike që nuk ekziston aktualisht.

Vlerësimet e ndryshimeve në flukset e ardhshme monetare të parashikuara, reflektojnë dhe janë lidhur në mënyrë konsistente me ndryshimet e të dhënave të lidhura nga periudha në periudhë (të tilla si normat e papunësisë, cmimet e pronës, cmimet e produkteve, fuqia paguese ose faktorët e tjerë që janë tregues të humbjeve të shkaktuara në grup dhe të magnitudës së tyre).

Metodologjia dhe supozimet e përdorura për flukset e ardhshme të parashikuara janë rishikuar rregullisht për të zvogeluar ndonjë diferencë midis humbjes së parashikuar dhe eksperiencës së humbjes aktuale.

### Vlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Bazuar në specifikën e aktivitetit të Grupit duke marrë në konsideratë politikat e UKT sh.a. për vjeljen e detyrimeve të prapambetura me vështirësi arkëtimi, Sektori i Menaxhimit të Riskut, në varësi të mënyrës së matjes së konsumit të ujit dhe moshës së debisë, ka klasifikuar portofolin e debisë sipas kategorive të abonentëve në 4 klasa risku sipas kriterëve të shpjeguara më poshtë:

#### Klasa 1 - Rrezikshmëria 22.5 %

- "Me Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer deri në 12 fatura.
- "Pa Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer deri në 6 fatura.

#### Klasa 2 - Rrezikshmëria 42.5 %

- "Me matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer deri në 12-18 fatura.
- "Pa matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer 6-12 fatura.

#### Klasa 3 - Rrezikshmëria 62.5 %

- "Me Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer deri në 18-30 fatura.
- "Pa Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer deri në 12-24 fatura.

#### Klasa 4 - Rrezikshmëria 87.5 %

- "Me Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer mbi 30 fatura.
- "Pa Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer mbi 24 fatura.

Sipas mënyrës së matjes për çdo kategori abonentit dhe moshës së debisë, është klasifikuar debia deri më datë 31.12.2015 sipas klasave të riskut të përcaktuara më sipër dhe në bazë të kësaj është përlogaritur vlera e provigjonimit duke marrë në konsideratë edhe vlerën e provigjonuar në vitin 2014. Aktualisht, vlera e provigjonimit sipas klasave është specifikuar si më poshtë:

Klasa 1				
Kategoria e Abonentit	Debia më datë 31.12.2015	Përqindja e provigjonimit deri 31.12.2014	Përqindja e provigjonimit sipas klasave të Riskut	Shuma e provigjonit më 31.12.2015
Buxhetorë	55 967 608	8.7%	22.50%	1 095 564
Familjarë	67 101 275	49.7%	22.50%	7 508 129
Familjarë pa kanal	16 366 426	77.1%	22.50%	2 837 693
Jo-Buxhetorë	1 000 419	7.8%	22.50%	17 512
Privat	62 598 897	6.8%	22.50%	961 989
Privat pa kanal	4 961 313	31.1%	22.50%	346 721
<b>Totali – Klasa 1</b>	<b>207 995 939</b>			<b>12 767 610</b>



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

## Klasa 2

Kategoria e Abonentit	Debia më datë 31.12.2015	Përqindja e provigjonimit deri 31.12.2014	Përqindja e provigjonimit sipas klasave të Riskut	Shuma e provigjonit më 31.12.2015
Buxhetorë	11 456 781	8.7%	42.50%	423 614
Familjarë	14 615 200	49.7%	42.50%	3 088 959
Familjarë pa kanal.	6 091 479	77.1%	42.50%	1 994 990
Jo-Buxhetorë	4 346 500	7.8%	42.50%	143 717
Privat	16 514 741	6.8%	42.50%	479 382
Privat pa kanal	1 350 855	31.1%	42.50%	178 320
<b>Totali – Klasa 2</b>	<b>54 375 556</b>			<b>6 308 982</b>

## Klasa 3

Kategoria e Abonentit	Debia më datë 31.12.2015	Përqindja e provigjonimit deri 31.12.2014	Përqindja e provigjonimit sipas klasave të Riskut	Shuma e provigjonit më 31.12.2015
Buxhetorë	25 076 485	8.7%	62.50%	1 363 534
Familjarë	42 644 894	49.7%	62.50%	13 254 566
Familjarë pa kanal.	16 626 429	77.1%	62.50%	8 007 700
Jo-Buxhetorë	48 629 994	7.8%	62.50%	2 364 634
Privat	22 572 791	6.8%	62.50%	963 576
Privat pa kanal	2 613 093	31.1%	62.50%	507 267
<b>Totali – Klasa 3</b>	<b>158 163 679</b>			<b>26 461 277</b>

## Klasa 4

Kategoria e Abonentit	Debia më datë 31.12.2015	Përqindja e provigjonimit deri 31.12.2014	Përqindja e provigjonimit sipas klasave të Riskut	Shuma e provigjonit më 31.12.2015
Buxhetorë	14 745 090	8.7%	87.50%	1 122 470
Familjarë	1 425 004 231	49.7%	87.50%	620 072 779
Familjarë pa kanal.	327 363 781	77.1%	87.50%	220 733 213
Jo-Buxhetorë	10 765 766	7.8%	87.50%	732 879
Privat	262 832 139	6.8%	87.50%	15 707 506
Privat pa kanal	17 267 735	31.1%	87.50%	4 692 939
<b>Totali – Klasa 4</b>	<b>2 057 978 743</b>			<b>863 061 786</b>

Sa më sipër, vlera totale e provigjonimit sipas kategorive të abonentëve, referuar vlerës së debisë deri më 31.12.2015, është:

Kategoria e Abonentit	Debia më datë 31.12.2015	Shuma e provigjonit deri më 31.12.2015	% Provigjonit
Buxhetorë	107 245 964	4 005 184	3.7%
Familjarë	1 549 365 601	643 924 434	41.6%
Familjarë pa kanal.	366 448 107	233 573 596	63.7%
Jo-Buxhetorë	64 742 679	3 258 742	5.0%
Privat	364 518 568	18 112 452	5.0%
Privat pa kanal	26 192 997	5 725 246	21.9%
<b>Grant Total</b>	<b>2 478 513 916</b>	<b>908 599 655</b>	<b>36.7%</b>

Ujja e vlerës së provigjonimit krahasuar më atë të një viti më parë, reflekton masat administrative dhe ligjore që janë ndërmarrë nga Shoqëria, si dhe të funksionimit më efikas të strukturave të saj gjatë vitit 2015.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

#### 4.4 Flukset monetare dhe rreziku i vlerës së drejtë të normës së interesit

Grupi është e ekspozuar ndaj ndikimeve që luhatjet në nivelet e normës së interesit që mbizotërojnë në treg kanë në bilancin kontabël dhe flukset e saj te parasë. Drejtimi i Grupit është përgjegjës për monitorimin ditor të pozicionit të rrezikut të normës neto të interesit dhe vendos limite për të reduktuar ndikimin e luhatjes të normës së interesit. Luhatjet e normës së interesit të tregut me të cilën janë marrë fonde hua mund të kenë efekt negativ në performancën financiare të shoqërisë. Në të njëjtën kohë, shoqëria nuk ka vendosur aktive të shumta në depozita me afat dhe në letra me vlerë shumë likuide, duke përfituar të ardhura interesi shtesë.

2015	Nuk mbartin interes	Totali	Mbartin interes
<b>Aktivët financiarë</b>			
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	396,917	396,917	-
Llogarite e arketueshme	2,716,829	2,716,829	-
<b>Totali aktive financiare</b>	<b>3,113,746</b>	<b>3,113,746</b>	<b>-</b>
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perlllogaritura	2,599,551	2,599,551	-
Detyrime ndaj personelit	77,897	77,897	-
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	189,850	189,850	-
Huamarrje afatshkurter	-	1,409,061	1,409,061
Huamarrje afatgjata	-	5,188,890	5,188,890
Grante	494,102	494,102	-
<b>Totali detyrime financiare</b>	<b>3,361,400</b>	<b>9,959,351</b>	<b>6,597,951</b>
<b>Hendeku i normës së interesit</b>	<b>(247,654)</b>	<b>(6,845,605)</b>	<b>(6,597,951)</b>
<b>2014</b>			
<b>Aktivët financiarë</b>			
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	11,590	11,590	-
Llogarite e arketueshme	1,882,903	1,882,903	-
<b>Totali aktive financiare</b>	<b>1,894,493</b>	<b>1,894,493</b>	<b>-</b>
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perlllogaritura	1,474,680	1,474,680	-
Detyrime ndaj personelit	14,393	14,393	-
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	330,209	330,209	-
Huamarrje afatshkurter	-	1,132,019	1,132,019
Huamarrje afatgjata	-	5,751,744	5,751,744
Grante	509,383	509,383	-
<b>Totali detyrime financiare</b>	<b>2,328,665</b>	<b>9,212,428</b>	<b>6,883,763</b>
<b>Hendeku i normës së interesit</b>	<b>(434,172)</b>	<b>(7,317,935)</b>	<b>(6,883,763)</b>

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Instrumentat financiare që mbartin interes më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 janë huatë afatgjata. Normat e interesit janë fikse përveç huasë të marrë nga UKT Sh.a nga Banka Kombetare Tregtare (BKT). Kjo bën që Grupi të mos jetë i ekspozuar ndaj ndryshimit të normës së interesit vetëm për këtë kredi. Analiza e sensitivitetit për ndryshimin e normës së kredisë monitorohet vetëm për kredinë ndaj BKT.

Nje paraqitje e rritjes/pakësimit të normës së interesit të kredise ndaj BKT paraqitet si më poshtë:

2015	Skenari deri në 1 (një) vit		Skenari mbi 1 (një) vit	
	100 bp Pakësim	100 bp Pakësim	100 bp Pakësim	100 bp Pakësim
Efektet e vlerësuara në Rezultat	16.481	38.418	5.513	49.386

Lëvizjet e normave të interesit sipas skenarëve të mësipërm influencojnë të ardhurat nga rezultati financiar si dhe vlerën e drejtë të tyre. Normat mesatare të interesit të aplikuara për zërat kryesore të detyrimeve financiare paraqiten si në vijim:

Normat e interesit dhe afati i kthimit Kredi (Euro)		
Kredia	Norma e interesit %	Lloji i interesit
F.ROT/AID-95/007/00	1%	Fix
F.ROT/AID-94/006/00	1%	Fix
F.ROT/AID-99/004/00	1%	Fix
F.ROT/AID-99/004/00	0.50%	Fix
F.ROT/AID-99/010/00	0.50%	Fix
F.ROT/AID-98/001/00	1%	Fix

Normat e interesit dhe afati i kthimit Kredi (Lekë)		
Kredia	Norma e interesit %	
Kredi blerje HEC	BTH + 2%	Variabel

#### 4.5 Rreziku i likuiditetit

Grupi menaxhon nevojat e tij për likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e skeduluara të borxhit që rezultojnë nga detyrimet financiare si dhe parashikon hyrjet dhe daljet monetare në biznesin e përditshëm. Nevojat për likuiditet monitorohen në kohë të ndryshme. Kërkesat neto për para krahasohen me huamarrjet e disponueshme në mënytë që të përcaktohet çdo mungesë. Kjo analizë tregon nëse huamarrjet e disponueshme priten të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës së vëzhguar. Grupi mban para për të përballuar kërkesat për likuiditet për një periudhë minimalisht prej 30 ditësh.

Grupi ka si burim kryesor të financimit të aktiveve të saj kapitalin e aksionerëve dhe huatë afatgjata të dhëna nga fondit i ndihmës së qeverive të huaja nëpërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktura (Njesisë së Menaxhimit të Projekteve të Huaja). Llogaritë e arketueshme janë të pagueshme deri në 30 ditë dhe huatë afatgjata kanë afatë maturimi kontraktuale nga 20 deri në 30 vjet.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, detyrimet e shoqërisë kanë maturitete kontraktuale (përfshirë pagesat e interesit kur aplikohen) si më poshtë:

2015	0 - 12 muaj	2 - 5 vjet	Më tepër se 5 vjet	Totali
<b>Aktive financiare</b>				
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	396,917	-	-	396,917
Llogarite e arketueshme	2,716,829	-	-	2,716,829
<b>Aktive financiare gjithsej</b>	<b>3,113,746</b>	-	-	<b>3,113,746</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perlllogaritura	2,599,551	-	-	2,599,551
Detyrime ndaj personelit	77,897	-	-	77,897
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	189,850	-	-	189,850
Huamarrje afatshkurter	1,409,061	-	-	1,409,061
Huamarrje afatgjata	-	1,262,516	3,926,374	5,188,890
Grante	-	-	494,102	494,102
<b>Detyrime financiare gjithsej</b>	<b>4,276,391</b>	<b>1,262,516</b>	<b>4,420,476</b>	<b>9,959,383</b>
<b>Hendeku i maturitetit</b>	<b>(1,162,645)</b>	<b>(1,262,516)</b>	<b>(4,420,476)</b>	<b>(6,845,637)</b>
<b>2014</b>				
	<b>6 - 12 muaj</b>	<b>1 - 2 vjet</b>	<b>Më tepër se 5 vjet</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktive financiare</b>				
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	11,590	-	-	11,590
Llogarite e arketueshme	1,882,903	-	-	1,882,903
<b>Aktive financiare gjithsej</b>	<b>1,894,494</b>	-	-	<b>1,894,494</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogarite e paguesheme dhe detyrime te perlllogaritura	1,474,680	-	-	1,474,680
Detyrime ndaj personelit	14,393	-	-	14,393
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	330,209	-	-	330,209
Huamarrje afatshkurter	1,132,019	-	-	1,132,019
Huamarrje afatgjata	-	1,262,516	4,489,227	5,751,744
Grante	-	-	509,383	509,383
<b>Detyrime financiare gjithsej</b>	<b>2,951,301</b>	<b>1,262,516</b>	<b>4,998,611</b>	<b>9,212,428</b>
<b>Hendeku i maturitetit</b>	<b>(1,056,807)</b>	<b>(1,262,516)</b>	<b>(4,998,611)</b>	<b>(7,317,934)</b>



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

#### 4.6 Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Objektivat e Grupit në lidhje me menaxhimin e kapitalit janë të ruajnë aftësinë e Grupit për të vazhduar aktivitetin, bazuar në parimin e vijmësisë me qëllim që të sjellë kthime për aksionerët. Grupi monitoron kapitalin e tij mbi bazën e normës së borxhit. Kjo normë llogaritet si raport i borxhit neto me kapitalin total.

Borxhi neto llogaritet si total i huave (duke përfshirë huatë afatgjata dhe huatë afatshkurtra të paraqitura në bilancin kontabël) minus paratë dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Kapitali total llogaritet si vlera e kapitalit që paraqitet në bilancin kontabël plus huanë neto. Norma e borxhit më 31 dhjetor 2015 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2015 lekë	31 dhjetor 2015 lekë
Huamarrja	6,597,951	6,883,763
Minus – Mjete Monetare dhe të ngjashme	(396,917)	(11,590)
Borxhi Neto	6,201,035	6,872,173
<b>Kapitali Neto</b>	<b>7,190,599</b>	<b>6,656,825</b>
<b>Kapitali Total</b>	<b>13,391,634</b>	<b>13,528,998</b>
<b>Norma e Borxhit</b>	<b>0.46</b>	<b>0.51</b>

#### 4.7 Vlerësimi me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson vlerën me të cilën një aktiv mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në kushtet e tregut. Vlera e drejtë është bazuar në supozimin e drejtimit në përputhje me profilin e bazës së aktivitetit dhe të detyrimit.

##### 4.6.1 Instrumentet financiare të prezantuar me vlerë të drejtë

Aktivitetet financiare të matura me vlerë të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar janë në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë e cila i grupon aktivitetet dhe detyrimet financiare në tre nivele bazuar në rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve financiare. Hierarkia e vlerës së drejtë është si vijon:

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (të pakorrigjuara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime financiare të ngjashme;
- **Niveli 2:** të dhëna të tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë të disponueshme për aktivitetet dhe detyrimet e observuara, direkt (p.sh. çmimet) ose indirekt (të dhëna nga çmimet) dhe
- **Niveli 3:** të dhëna mbi aktivitetet dhe detyrimet që nuk janë të bazuar në të dhëna të disponueshme nga observimi i tregut

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 Grupi nuk ka aktive të klasifikuara në asnjë nga kategoritë e mësipërme.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

31 dhjetor 2015

Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

**4.6.2 Instrumente financiare që nuk janë prezantuar me vlerë të drejtë**

Tabela në vijim tregon një përmbledhje të vlerave kontabël neto dhe vlerave të drejta të atyre aktiveve financiare dhe detyrimeve që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë:

	Vlera e drejte		Vlera e drejte	
	2015	2014	2015	2014
<b>Aktive financiare</b>				
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	396,917	11,590	396,917	11,590
Llogarite e arkëtueshme	2,716,829	1,882,903	2,716,829	1,882,903
<b>Aktive financiare gjithsej</b>	<b>3,113,746</b>	<b>1,894,494</b>	<b>3,113,746</b>	<b>1,894,494</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogarite e pagueshme dhe detyrime te perllogaritura	2,599,551	1,474,680	2,599,551	1,474,680
Detyrime ndaj personelit	77,897	14,393	77,897	14,393
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	189,850	330,209	189,850	330,209
Huamarrje afatshkurter	1,409,061	1,132,019	1,409,061	1,132,019
Huamarrje afatgjata	5,188,890	5,751,744	5,188,890	5,751,744
Grante	494,102	509,383	494,102	509,383
<b>Detyrime financiare gjithsej</b>	<b>9,959,351</b>	<b>9,212,428</b>	<b>9,959,351</b>	<b>9,212,428</b>

**Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme**

Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme janë mbajtur me kosto të amortizuar, minus provizionet për zhvlerësim. Vlera e tyre korrespondon me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturitetit afat shkurtër.

**Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre**

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre konsiderohet të jetë e përafërt me vlerat respektive kontabël si pasojë e maturimit të tyre më të shkurtër se tre muaj.

**Llogari dhe hua të pagueshme**

Vlerat kontabël të llogarive të pagueshme dhe huave të pagueshme përafrohen me vlerën e tyre të drejtë për shkak të maturitetit afat shkurtër. Huatë me norma interesi variable përafrohen me vlerën e tyre të drejtë për shkak të faktit që normat variable të interesit konsiderohen si norma interesi të tregut.

**5 Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme kontabël**

Grupi kryen supozime dhe bën vlerësime të cilat kanë ndikim në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Gjykimet vlerësohen vazhdimisht bazuar në eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme sipas rrethanave.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Në aplikimin e politikave kontabël të Grupit, që përshkruhen në Shënimin Nr. 3 të këtyre pasqyrave financiare, drejtimit i kërkohet që të bëjë gjykimë, çmuarje, dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë qartësisht të dukshme nga burime e tyre. Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto çmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet në çmuarjet kontabël do të njihen në periudhën në të cilën çmuarja është rishikuar në qoftë se rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudhat e ardhshme në qoftë se rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe ato të ardhme.

*(i) Të ardhurat nga shitja e produkteve të rregulluara*

Njohja e të ardhurave për klientët të cilët janë objekt matjeje përfshin një vlerësim të vlerës së ujit të konsumuar dhe të tjera shërbime të lidhura midis datës së fundit të matjes dhe datës së fundit të periudhës ushtrimore. Në datën e bilancit kjo shumë është për tu faturuar në datën tjetër të matjes. Drejtimi mendon që përlllogaritja e konsumit për periudhën afersisht 31 ditore për klientet paraqet besueshem vëllimin e të ardhurave që realizohen gjatë kësaj periudhe. Megjithatë ndryshimi në këto supozime nuk do të ketë efekte materiale në raportimin e të ardhurave.

*(ii) Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme*

Drejtimi rishikon në mënyrë të vazhdueshme jetën e dobishme të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmërinë e pritur të këtyre aktiveve. Vlera e mbetur e këtyre aktiveve është analizuar në Shënimin Nr. 6. Megjithatë, rezultatet reale mund të ndryshojnë për shkak të konsumimit teknologjik.

*(iii) Inventari*

Inventarët janë matur me koston më të vogël të vlerës së realizueshme. Vlera neto e realizueshme është cmimi i parashikuar i shitjes gjatë aktivitetit normal të biznesit, minus kostot e vleresuara të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Inventari dhe prodhimi në proces vlerësohen me vlerën më të vogël midis koston (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti) dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes.

*(iv) Rënia në vlerë e llogarive të arkëtueshme*

Shoqëria llogarit zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshmeve të tjera bazuar në humbjet e vlerësuara që rezultojnë nga paafësia e klientëve për të bërë pagesat e detyrimeve të tyre. Vlerësimi është bazuar në analizën e vjetërsisë të llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën historike të nxjerrjes jashtë librave kontabël, cilësinë e klientit dhe ndryshimet në termat e pagesës së klientit kur vlerësohet saktësia e humbjes nga zhvlerësimi për llogaritë e dyshimta. Kjo përfshin supozime për sjelljen e ardhshme të klientit dhe mbledhjet e ardhshme të parave. Në qoftë se kushtet financiare të klientit përkeqësohen, çregjistrimet aktuale të llogarive të arkëtueshme ekzistuese mund të jenë më të larta se sa priten dhe mund të kalojnë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri tani.



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

## Informacioni krahasues

Pasqyra e pozicionit financiar të vitit krahasues të mbyllur me 31 dhjetor 2014 është riparaqitur si me poshte:

	31 dhjetor 2014			31 dhjetor 2013		
	Riparaqitur	Rregullime	Viti ushtrimor i mbyllur	Riparaqitur	Rregullime	Viti ushtrimor i mbyllur
	mijë Lek	mijë Lek	mijë Lek	mijë Lek	mijë Lek	mijë Lek
<b>Aktivet</b>						
<b>Aktivet afatgjata</b>						
Aktive afatgjata materiale	12,379,777	1,026,002	11,353,775	12,006,408	948,321	11,058,087
Aktive afatgjata jo materiale	1,216,837	-	1,216,837	1,477,587	-	1,477,587
<b>Total</b>	<b>13,596,614</b>	<b>1,026,002</b>	<b>12,570,612</b>	<b>13,483,995</b>	<b>948,321</b>	<b>12,535,674</b>
<b>Aktivet afatshkurtra</b>						
Inventari	394,680	-	394,680	356,843	-	356,843
Llogari të arkëtueshme	1,882,903	(9,652)	1,892,555	1,614,565	-	1,614,565
Mjete monetare dhe të ngjashme	11,590	393	11,197	16,019	-	16,019
Aktive të tjera	-	(1,011,281)	1,011,281	-	(948,321)	948,321
<b>Total</b>	<b>2,289,173</b>	<b>(1,020,540)</b>	<b>3,309,713</b>	<b>1,987,427</b>	<b>(948,321)</b>	<b>2,935,748</b>
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>15,885,787</b>	<b>5,462</b>	<b>15,880,325</b>	<b>15,471,422</b>	<b>-</b>	<b>15,471,422</b>
<b>Detyrimet dhe Kapitali</b>						
<b>Kapitali</b>						
Kapitali aksioner	2,544,398	-	2,544,398	2,544,398	(17,173)	2,561,571
Rezerva nga rivlerësimi	3,219,601	-	3,219,601	3,219,601	-	3,219,601
Rezerva ligjore	79,746	-	79,746	79,746	17,173	62,573
Rezerva statutoare	3,681	-	3,681	3,681	-	3,681
Fitimi i mbartur	374,606	(20,618)	395,224	(205,981)	(20,618)	(185,363)
Fitimi i periudhës	434,793	10,784	424,009	580,587	-	580,587
<b>Kapitali neto</b>	<b>6,656,825</b>	<b>(9,834)</b>	<b>6,666,659</b>	<b>6,222,032</b>	<b>(20,618)</b>	<b>6,242,650</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>						
Huamarrje afatgjata	5,751,744	-	5,751,744	6,026,193	-	6,026,193
Grante	509,383	-	509,383	525,138	-	525,138
Detyrimi tatimor i shtyre	16,534	-	16,534	-	-	-
<b>Total</b>	<b>6,277,661</b>	<b>-</b>	<b>6,277,661</b>	<b>6,551,331</b>	<b>-</b>	<b>6,551,331</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>						
Llogari të pagueshme dhe detyrime të përlogaritura	1,474,680	(5,320)	1,480,000	1,312,567	-	1,312,567
Detyrime ndaj personelit	14,393	366	14,027	45,002	-	45,002
Detyrime ndaj Shtetit	330,209	20,136	310,073	352,549	20,618	331,931
Huamarrje afatshkurtra	1,132,019	114	1,131,905	987,941	-	987,941
<b>Total</b>	<b>2,951,301</b>	<b>15,296</b>	<b>2,936,005</b>	<b>2,698,059</b>	<b>20,618</b>	<b>2,677,441</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>9,228,962</b>	<b>15,296</b>	<b>9,213,666</b>	<b>9,249,390</b>	<b>20,618</b>	<b>9,228,772</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>	<b>15,885,787</b>	<b>5,462</b>	<b>15,880,325</b>	<b>15,471,422</b>	<b>-</b>	<b>15,471,422</b>



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

31 dhjetor 2015

Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Rregullimet për riparqitjen e pasqyrës së pozicionit financiar për vitin 2014 dhe 2013 përfshijnë:

Riklasifikimin e shumës 1,026,002 mijë lekë ( 2013 - 948,321 mijë lekë) nga aktive të tjera në aktive në proces për punime të kryera nga nënkontraktore të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetilës Kanalizime (DPUK).

Korrigjimet për veprimet eliminuese gjatë konsolidimit të pasqyrave financiare të UKT sh.a dhe HEC Lanabregas Sh.a. për llogaritë e arkëtueshme për shumën 9,652 mijë lekë dhe të pagueshme për shumën 5,320 mijë lekë si dhe rregullimin për shumën 114 mijë lekë për vitin 2014 nga huamarrje të tjera të Shoqërisë Hec lanabregas në konsolidim dhe detyrime ndaj personelit për shumën 366 mijë lekë.

Riklasifikimin e shumës debitore 20,618 mijë lekë nga fitimet e mbartura në detyrime ndaj shtetit si korrigjim i sistemeve të viteve të mëparshme dhe riklasifikimin e shumës 17,173 mijë lekë për korrigjimin e gjendjes së mbartur të rezervave ligjore dhe kapitalit.

Udhëtimi Kanalizime Tiranë Sh.a.

Grupimi Financiar të Konsoliduar

31 dhjetor 2015

Shënimet janë në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

### 6 Aktive Afatgjata Materiale

Kosto	Toka	Ndërtesa	Rrjeti Kanalizim	Rrjeti Ujësjellës	Makineri dhe Pajisje Pune	Mjete Transporti	Pajisje zyre dhe të ngjashme	Punime në proces	Asete në magazinë	Total
Gjendja më 1 janar 2014	2,155,486	4,351,343	498,153	2,204,055	200,398	101,839	61,843	2,499,099	47,636	12,119,851
Blerjet gjatë vitit	-	-	1,300	13,190	8,303	26,486	12,058	473,991	14,358	549,686
Shtesa inventari	-	-	-	-	-	-	-	-	8,651	8,651
Transferime & Sistemime	-	169,453	17,158	779,732	(43,468)	(505)	1,161	(919,715)	(3,816)	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>2,155,486</b>	<b>4,520,795</b>	<b>516,611</b>	<b>2,996,976</b>	<b>165,233</b>	<b>127,820</b>	<b>75,062</b>	<b>2,053,375</b>	<b>66,831</b>	<b>12,678,188</b>
Gjendja më 1 janar 2015	2,155,486	4,520,795	516,611	2,986,976	165,233	127,820	75,062	2,053,375	66,831	12,678,188
Blerjet gjatë vitit ushtrimor	-	-	-	2,953	12,330	37,652	10,050	524,915	10,889	598,789
Transferime	-	8,718	45,916	9,009	6,418	(1,208)	(9,979)	(68,365)	3,136	(6,356)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>2,155,486</b>	<b>4,529,513</b>	<b>562,527</b>	<b>3,008,938</b>	<b>183,981</b>	<b>164,284</b>	<b>75,133</b>	<b>2,509,925</b>	<b>80,856</b>	<b>13,270,621</b>
Amortizimi i akumuluar										
Gjendja më 1 janar 2014	-	-	-	-	2,471	-	13,888	-	19,569	35,928
Amortizimi për vitin	-	84,000	18,603	108,992	14,489	21,702	12,047	-	2,649	262,482
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>-</b>	<b>84,000</b>	<b>18,603</b>	<b>108,992</b>	<b>16,961</b>	<b>21,702</b>	<b>25,935</b>	<b>-</b>	<b>22,218</b>	<b>298,410</b>
Gjendja më 1 janar 2015	-	84,000	18,603	108,992	16,961	21,702	25,935	-	22,218	298,410
Amortizimi për vitin	-	83,225	18,954	118,162	12,969	23,359	11,141	-	1,752	269,562
Transferime & Sistemime	-	167,224	37,556	227,154	27,522	45,062	37,076	-	26,377	567,972
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>-</b>	<b>314,449</b>	<b>56,513</b>	<b>336,146</b>	<b>44,483</b>	<b>66,764</b>	<b>63,011</b>	<b>-</b>	<b>48,597</b>	<b>627,282</b>
Vlera Neto Kontabel 31 dhjetor 2014	2,155,486	4,436,795	498,008	2,887,984	148,272	106,118	49,127	2,053,375	44,613	12,379,777
Vlera Neto Kontabel 31 dhjetor 2015	2,155,486	4,362,289	524,971	2,781,784	156,459	119,202	38,057	2,509,925	58,479	12,702,649

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, shoqëria nuk ka asnjë aktiv afatgjatë material të vënë si kolateral.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

## 7 Aktive Afatgjata Jo-Materiale

Asambleja e Aksionerëve të UKT sh.a, me datë 16.01.2013, vendosi të aprovojë Marrëveshjen e Bashkimit me përthithje të Shoqërive Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a dhe HEC Lanabregas sh.a ku Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a është shoqëria përthithese dhe Shoqëria HEC Lanabregas sh.a është shoqëria e përthithur. Ky operacion sipas Marrëveshjes është realizuar mbi të dhënat e datës 30 shtator 2012. Grupi ka përshtfshirë në aktivet afatgjata materiale emrin i mirë i cili ka lindur gjatë kombinimit të pasqyrave financiare të UKT sh.a dhe HEC Lanabregas Sh.a në momentin e përthithjes.

	Emri i Mirë	Totali
<b>Kosto</b>		
Më 1 janar 2014	1,477,590	1,477,590
Renië në vlerë	(260,753)	(260,753)
<b>Më 31 dhjetor 2014</b>	<b>1,216,837</b>	<b>1,216,837</b>
Më 1 janar 2015	1,216,837	1,216,837
Renië në vlerë	(260,753)	(260,753)
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>956,084</b>	<b>956,084</b>

HEC Lanabregas Sh.a është ndarë si Shoqëri më vehte nga UKT më datë 18.07.2014.

## 8 Inventari

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Materiale-Rrjetet	269,221	297,886
Pjese Kembimi	30,361	36,226
Materiale Konsumi	44,053	40,816
Kimikate	1,099	9,120
Inventari i imet	23,569	27,346
Te tjera	15,345	11,248
Inventari i pamberritur	22,456	-
Materiale jashte perdorimit	29,786	29,786
Humbje nga rënia në vlerë e Inventarit	(57,749)	(57,749)
<b>Total</b>	<b>378,142</b>	<b>394,680</b>

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

### 9 Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë shumat e të drejtave që i kanë lindur Grupit nga aktiviteti i shitjes, të shprehura neto nga humbja e vlerës që rrjedh si rezultat i vlerësimit të mosërkëtueshmërisë së këtyre llogarive.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Konsumatore familjare	2,012,784	1,827,318
Subjekte private	540,099	498,868
Ente buxhetore	107,652	133,868
Komuna	134,403	95,991
Kliente Per Taksa Bashkie	540,424	406,787
KESH sha	245,892	19,311
Tjerë	68,103	3,965
Zhvlerësimi i Llogarive të Arkëtueshme	(932,527)	(1,103,205)
<b>Total</b>	<b>2,716,829</b>	<b>1,882,903</b>

Lëvizjet në llogarinë e zhvlerësimit nga rreziku i mosarkëtimit paraqiten në vijim:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<b>Gjendja ne fillim</b>	<b>1,103,205</b>	<b>1,018,832</b>
Shtesat	-	84,373
Pakësimet	(170,678)	-
<b>Gjendja në fund</b>	<b>932,527</b>	<b>1,103,205</b>

### 10 Mjete Monetare dhe të ngjashme

Llogaritë me bankat përfaqësojnë gjëndjet e mjeteve monetare të depozituara pranë Bankave në formën e llogarive rrjedhëse, depozitave etj. Në fund të periudhës ushtrimore, këto llogari paraqiten si vijon:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<b>Llogari Rrjedhëse në Bankë</b>		
LEK	396,405	11,078
EUR	3	3
USD	509	466
<b>Total</b>	<b>396,917</b>	<b>11,547</b>
<b>Mjete monetare në Arkë</b>		
LEK	-	43
<b>Total i mjeteve monetare</b>	<b>396,917</b>	<b>11,590</b>



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Llogarite rrjedhese ne banke analizohen si vijon:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Banka Kombetare Tregtare ("BKT") Albania	330,144	8,655
Credins Banka Albania	65,029	1,479
Union Bank Albania	52	52
NBG Bank Albania	40	822
Procredit Bank Albania	39	11
Intesa Sanpaolo Bank Albania	27	27
American Bank of Investment ("ABI") Albania	-	4
Alpha Bank Albania	585	15
United Bank of Albania ("UBA") Albania	278	445
Tirana Bank Albania	42	7
EasyPay Albania	585	31
Raiffeisen Bank ("RZB") Albania	95	-
<b>Total</b>	<b>396,917</b>	<b>11,547</b>

Në vijim të kontratës së kredisë me Bankën Kombëtare Tregtare, UKT sh.a ka lënë garanci pranë kësaj banke llogarite e arkëtueshme.

## 11 Kapital

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a ("UKT" ose "Shoqëria") është krijuar me vendimin e gjykatës Tiranë nr.24875, datë 28.12.2000, në vijim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, bazuar në vendimin e aksionerit të vetëm, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për Krijim e Ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Qytet sh.a., me kapital aksioner prej lekë 2,008,900,000, aksione 2,008,900 me vlerë nominale 1000 lekë /aksioni, tërësisht i paguar me kontribute në natyrë.

Me Vendim nr.228, datë 04.06.2003, aksioneri i vetëm "Ministria e Ekonomisë" vendosi bashkimin me përthithje të Ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Qytet, me Ndërmarrjen e Ujësjetllës Fshat, krijuar me vendim gjykatë nr.27377, datë 12.03.2002, vendim i regjistruar në Gjykatën e Tiranës, nr.24875/2, datë 17.07.2003. Pas këtij bashkimi, kapitali i Shoqërisë u bë 2,561,571,000 lekë, numri i aksioneve në vlerën prej 2,561,571 lekë, ku vlera nominale është 1,000 lekë/aksioni.

Në 24 janar 2007, me numrin e cështjes: CN-109845-12-07, kuota që mbahej nga aksioneri i vetëm (Ministria e Ekonomisë të Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë) u transferua në pronësi të njësisve vendore të zonës së shërbimit që përbëhet nga 3 Bashki dhe 16 Komuna. Me datë 14.01.2010, numri i cështjes: CN-334160-01-10, kapitali i Shoqërisë u zvogelua nga 2,561,571,000 lekë në 2,544,398,050 lekë. Ndërkaq, numri i aksioneve ishte 2,561,571 lekë dhe u bë 2,544,398 lekë.

Kapitali i shoqërisë është 2.544.398.050 lekë, dhe është i ndarë në 2.544.398 aksione me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë secili.

Aksionet zotërohen nga aksionarët sipas kësaj shpërndarje:

Bashkia Tiranë: 2.099.108.00 aksione ose 82.50 % të totalit të aksioneve;

Bashkia Kamëz: 371.486.00 aksione ose 14.60 % të totalit të aksioneve;

Pesqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Bashkia Vorë: 73.804,00 aksione ose 2,90 % të totalit të aksioneve.

## 12 Huamarrje afatgjata

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Bovilla - Konventa Financiare 22 Mid Lit - F.ROT/AID-95/007/00	823,218	928,828
Konventa Financiare 13 Mid Lit - F.ROT/AID-94/006/00	435,242	496,581
Konventa Financiare 53.2 Mid Lit - F.ROT/AID-99/004/00	2,293,791	2,341,578
Konventa Financiare 6.8 Mid Lit - F.ROT/AID-99/010/00	482,044	492,087
Projekti COMM'98-Konventa Financiare 22 Mid Lit - F.ROT/AID-98/001/00	53,524	59,192
Kredia nga BKT për shfrytëzimin e burimeve të Shën Mërisë	54,150	-
Kredia për blerjen e HEC Lanabregas nga BKT	1,046,921	1,433,477
<b>Total</b>	<b>5,188,890</b>	<b>5,751,744</b>

Gjatë periudhës 1993 – 2001, Qeveria e Shqipërisë, në vijim të planit të përbashkët të bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës Italiane, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, ka firmosur me Zyrën e Bashkëpunimit Italian, një sërë kontratash. Bazuar në këto kontrata, është përzgjedhur Banka Kombëtare Tregëtare (BKT) si bankë bazë për financimin e objektivit të këtyre kontratave.

Në vijim të asaj më sipër, BKT dhe Njësia e Menaxhimit të Projekteve të Huaja dhe/ose Ministria e Financave, janë palë e kontratave të kredisë së akorduar me UKT për zhvillimin e rrjetit të saj dhe asistencën teknike.

Përdorimi i kredive kryhet nga kredimarrësi kryesor, UKT-ja, por edhe nga Ministria përkatëse që ka firmosur kontratën. Si rrjedhojë, UKT detajon vecmas tërheqjet që janë realizuar prej saj, si dhe ato që kryhen prej Ministrive.

Informacioni për secilin kredi detajohet si më poshtë

### Bovilla-Konventa Financiare 22 Mid Lit-F.ROT/AID-95/007/00

E nënshkruar më 20.06.1996 midis Bankës Kombëtare Tregëtare të Shqipërisë dhe Njesisë së Drejtimit të Projektit pranë Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit dhe Ndërmarrjes së Ujësjetllës Tiranë, për shumën prej 22.000.000.000 Lireta italiane. Afati i kthimit të huasë është 30 vjet nga data e bërjes efektive të huasë.

Kushtet e huasë :

1. Ndërmarrja e Ujësjetllës Tiranë do të paguajë huadhënësit një normë vjetore interesi prej 1%, e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujore.
2. Ndërmarrja e Ujësjetllës Tiranë do të fillojë të shlyejë pjesën e principalit pas 12 viteve të bërjes efektive të huasë, i pagueshëm 2 herë në vit me këste 6 mujore.
3. Ndërmarrja e Ujësjetllës Tiranë do të paguajë huadhënësit një komision prej 0.75% të huasë së përdorur, i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

31 dhjetor 2015

Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

4. Të gjitha detyrimet e Ndërmarrjes së Ujësjetës Tiranë do të paguhen në monedhën në të cilën është dhënë huaja, ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të bëhet shlyerja.
5. Në rast se Ndërmarrja e Ujësjetës Tiranë nuk mund të përmbushë detyrimin e saj për të bërë pagesat në lidhje me principalin dhe interesin, atëherë huadhënësi në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Financave do të kërkojë Buxhetit të Shtetit të paguajë shumat përkatëse.

#### Konventa Financiare 13Mld Lit-F.ROD/AID-94/006/00

E lidhur më datë 05.04.1995 midis Bankës Kombëtare Tregtare të Shqipërisë ( BKTSH) që do të veprojë si bankë agente në emër dhe për llogari të Qeverisë dhe Ndërmarrjes së Ujësjetës Tiranë, për shumën prej 13.000.000.000 lireta.

Kushtet e huasë:

1. Afati maksimal i kthimit brenda 30 viteve. Ky afat do të jetë i negociueshëm mbi bazën e gjykimin që do të bëjë BKTSH sipas gjendjes ekonomiko-financiare të ndërmarrjes në të ardhmen.
2. Ndërmarrja e Ujësjetës Tiranë do të fillojë të shlyejë pjesën e principalit pas 10 viteve. Për këtë periudhë interesi do të paguhet.
  - Norma vjetore e interesit të bankës italiane 1%
  - Kthimi i kredisë dhe interesave do të bëhet me këste 6 mujore.
  - Kthimi i kredisë do të bëhet në të njëjten valutë me të cilën është dhënë kredia, ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën bëhet shlyerja.
  - Ndërmarrja e Ujësjetës Tiranë do të paguajë huadhënësit një komision prej 0.75% të huasë së përdorur , i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë.

#### Konventa Financiare 6.8 Mid Lit-F.ROT/AID-99/010/00

E lidhur më datë 18.09.2000 midis Bankës Kombëtare Tregtare Shqiptare dhe Ujësjetës Tiranë , për shumën prej 6.800.000.000 Lireta italiane. Afati i kthimit të huasë është 35 vjet nga data e bërjes efektive të huasë sipas Konventës Financiare të lidhur midis Qeverisë Italiane përfaqësuar nga Mediocredito Centrale dhe Qeverisë Shqiptare përfaqësuar nga Banka Kombëtare Tregtare.

Kushtet e huasë:

1. Norma vjetore e interesit prej 0.5%, do të jetë e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujoretë llogaritur mbi tepicën e kredisë.
2. Huamarrësi do të fillojë shlyerjen e pjesës principale të huasë pas 294 muajve të bërjes efektive të saj, i pagueshëm 2 herë në vit me këste 6 mujore.
3. Të gjitha detyrimet e huamarrësit do të paguhen në monedhën në të cilën është dhënë huaja, ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të bëhet shlyerja.



Pesqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

#### Konventa Financiare 53.2 Mld Lit-F.ROT /AID-99/004/00

Lidhur në bazë të ligjit Italian Nr.49, datë 26 Shkurt 1987 midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale-Istituto Centrale per il Credito a Medio Termine S.P.A për shumën prej 53.200.000.000.

Kushtet e huasë:

1. Kthimi: Në 22 këste 6 mujore të barabarta dhe të njëpasnjëshëm ku afati i pagimit të kështit të parë mbaron 294 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Financiare;
2. Përqindja e interesit: 0.5% interes nominal vjetor i cili do të paguhet në fund të gjashtëmujorit i cili fillon nga data e cdo përdorimi.
3. Destinacioni: Realizimi i një projekti rehabilitimi i rrjetit uhor të Tiranës dhe asistencë teknike në administrimin e ndërmarrjes së ujrave për përmirësimin e adiministrimit financiar dhe investimet që lidhen me këtë fushë.
4. Valuta e lëvrimit të kredisë: kredia do të lëvrohet në lireta italiane me kursin e këmbimit të Bankës Italiane.

#### Projekti COMM'98-Konventa Financiare 22 Mld Lit-F.ROT/AID-98/001/00

E lidhur më datë 25.08.1998 midis Bankës Kombëtare Tregtare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllësve për shumën 974.042.799 Lireta italiane dhe ka për objekt përdorimin e huasë për elektropompa dhe materiale për ndërmarrjet e ujësjetllësve. Afati i kthimit të huasë është 18 vjet nga data e bërjes efektive të huasë.

Kushtet e Huasë :

1. Norma vjetore e interesit prej 1%, do të jetë e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujoretë llogaritur mbi tepicën e kredisë.
2. Shlyerja e principalit të huasë do të fillojë pas 150 (njëqindpesëdhjetë) muajve të bërjes efektive të huasë, principal ky i pagueshëm 2 herë në vit me këste 6 mujore.
3. Huamarrësi do të paguajë huadhënësit një komision prej 0.75% të huasë së përdorur, i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë.
4. Të gjitha detyrimet e huamarrësit do të paguhet në monedhën në të cilën është dhënë huaja, ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të behet shlyerja.

#### Kredia nga BKT për shfrytëzimin e burimeve të Shën Mërisë

E lidhur me datë 31.07.2015 mes palëve: Banka Kombëtare Tregtare Sh.a dhe Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.a për shumën prej 1.000.000.000 lekë e cila do të përdoret për rikonceptimin e skemës së shfrytëzimit të burimeve të Shën Mërisë.

Dorëzanës : Shoqëria "HEC LANABREGAS"

Kushtet e huasë:



Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

31 dhjetor 2015

Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

1. Si kusht paraprak Kredimarrësi ka rënë dakord të paguajë shumën e kredisë dhe interesin mbi të. Dibursimi do të bëhet në cdo rast, vetëm pas paraqitjes së kopjes së faturës dhe të situacionit të punimeve të kryera.
2. Kredimarrësi do të hapë një ose më shumë llogari pranë Bankës Kombëtare Tregtare, Në të cilën Banka do të bëjë disbursimin e shumave përkatëse të kredisë dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi i tyre.
3. Kredimarrësi do të paguajë një komision angazhimi prej 0.4% mbi vlerën totale të kredisë e pagueshme para ditës së disbursimit. Në rast se rezultojnë pjesë të papërdorura të kredisë pas 1 muaji një komision prej 2% mbi bazë vjetore, e përlllogaritur mbi masën e papërdorur të kredisë deri në përfundim të kësaj periudhe.
4. Në rast të mospagimit të komisioneve dhe interesit, Banka ka të drejtë të aplikojë një penalitet prej 4% në muaj, mbi shumën e papaguar të komisionit dhe interesit.
5. Në rast se Kredimarrësi është në pamundësi për të ripaguar në kohë kështu e maturuar, Banka përveç normës së interesit normal ka të drejtë të aplikojë penalitet në masën 4% në muaj, i llogaritur mbi detyrimin e kështu të rradhës se papaguar.
6. Gjendja e fundit financiare e Kredimarrësit tregon që raportit: Detyrime/Kapitale të veta, është më i madh se 2:1.

#### Kredia për blerjen e Hec Lanabregas nga BKT

E lidhur më datë 30.05.2012 midis palëve: Banka Kombëtare Tregtare dhe Ujësjetillës Kanalizime Tiranë Sh.a për shumën prej 2.130.000.000 me anë të së cilës do të financojë blerjen e "HEC LANABREGAS".

Kushtet e huasë :

1. Kredimarrësi do të hapë një ose më shumë llogari pranë Bankës Kombëtare Tregtare, Në të cilën Banka do të bëjë disbursimin e shumave përkatëse të kredisë dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi i tyre.
2. Kredimarrësi garanton që kredia do të përdoret për qëllimin e marrjes së huasë, në të kundërt Banka ka të drejtë të kërkojë menjëherë rikthimin e kredisë dhe interesave të akumuluar, ose mund të aplikojë 1% penalitet mbi shumën fillestare të kredisë.

#### 13 Huamarrje afatshkurtra

Pershkrimi i Llogarive	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Hua - Pjesa Afatshkurte e Detyrimit Afatgjate	142,320	145,285
Këshilli mbikëqyres HEC	265	115
Hua-Detyrim ndaj Ministrisë së financave	1,031,747	886,462
Huaja -Interesa të përlllogaritur	41,452	40,239
Hua afatshkurter nga BKT për blerjen e HEC	193,278	59,919
Total	1,409,061	1,132,019

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

31 dhjetor 2015

Snumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

**14 Grante**

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Grante afatgjate – Prodhim	507,433	523,128
Grante afatgjate - Kanalizim shtese	1,949	2,009
Kalim në të ardhura nga Granti	(15,280)	(15,754)
<b>Total</b>	<b>494,102</b>	<b>509,383</b>

**15 Llogari të pagueshme dhe detyrime**

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Furnitore për investime afatgjate	479,609	246,392
Furnitorë për shërbime dhe mallra	1,416,707	688,501
Fatura të pamberitura	61,605	42,152
Furnitore garanci punimësh	121,655	107,064
Kreditore të tjerë	4,496	-
Detyrime të perlllogaritura Bashkia Tirane	515,479	390,571
<b>Total</b>	<b>2,599,551</b>	<b>1,474,680</b>

**16 Detyrime ndaj personelit**

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Paga	77,897	14,393
<b>Total</b>	<b>77,897</b>	<b>14,393</b>

**17 Detyrime ndaj shtetit dhe ISSH**

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Shteti Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore	14,810	15,276
Shteti Tatim Mbi të Ardhurat Personale	14,271	5,138
Shteti për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar	56,284	18,436
Shteti të Tjera Tatime Taksa	6,524	90,824
Shteti Tatim Fitimi Korrent	92,031	43,497
Shteti Tatim Fitimi I mbartur	5,930	157,038
<b>Total</b>	<b>189,850</b>	<b>330,209</b>

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

### 18 Të ardhurat nga shitja

Të ardhurat nga shitja përfaqesojnë të ardhurën që rrjedh si pasojë e shitjes së shërbimeve dhe produkteve të rregulluara dhe të parregulluara si më poshtë vijon:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Te ardhura nga konsumatore familjare	1,398,302	1,356,818
Te ardhura nga subjekte private	519,508	521,724
Te ardhura nga institucione buxhetore	328,027	359,343
Te ardhura nga institucione jo-buxhetore	61,793	67,420
Te Ardhura Kesh	166,338	204,740
Te Ardhura nga Tarifa Fikse e Sherbimit	237,256	223,565
Te ardhura nga Pikelidhjet	11,845	6,977
Te Ardhura Vendorsje matesash	31,416	40,713
Te Ardhura Azhornime rrjeti	638	1,512
Te Ardhura te Tjera Klientet	43,234	38,296
<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>2,798,357</b>	<b>2,821,108</b>

### 19 Të ardhurat të tjera

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të ardhura nga kamatvonesa, gjoba e penalitete	54,202	50,343
Të ardhura të tjera	73,677	72,010
Të ardhura nga grantet afat gjate	15,282	15,754
<b>Total</b>	<b>143,161</b>	<b>138,108</b>

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehen ndryshe

## 20 Shpenzime të përgjithshme prodhimi

Shpenzime të përgjithshme të prodhimit përfaqësojnë shpenzimet direkte që lidhen me procesin e shpërndarjes së ujit dhe kanalizimit. Si rrjedhojë, Grupi ka përfshirë kostot direkte të identifikuara si të tilla; materiale, punime e shërbime nga palët e treta e të tjera, mirëmbajtje të përgjithshme etj.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 20 14
Shpenzime Materiale Para - Mirembajtje Rrjeti	70,225	52,675
Shpenzime Materiale – Kimikate	71,673	95,229
Shpenzime Tjera - Karbon	46,263	28,270
Shpenzime Kancelerie- faturimi etj	13,045	10,070
Shpenzime Materiale Tjera - Mirembajtje	3,642	2,298
Shpenzime Shërbimesh dhe materiale mirembajtje rrjeti - asfaltim etj	6,828	7,797
Shpenzime Energjie Elektrike - Prodhimi	368,243	269,843
Shpenzime per uje dhe energji HEC	55,016	119,926
Shpenzime per punëtori HEC	15,344	-
Shpenzime Materiale - Matesat	43,312	41,755
Shpenzime Karburanti	50,340	49,075
Shpenzime materiale- Mirembajtje Makineri e Pajisje	23,541	16,930
Shpenzime - te pergjithshme	95,085	54,028
Shpenzime Sherbimesh -Mirembajtje e Pergjithshme	34,016	16,887
Shpenzime Energjie Elektrike	1,064	2,989
Qera	18,211	16,957
Te Tjera	8,305	20,014
<b>Total</b>	<b>924,152</b>	<b>804,743</b>

## 21 Shpenzime e përgjithshme dhe administrative

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative analizohen si me poshtë .

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Taksa Tatime te ngashme	7,724	11,737
Sherbime Keshilli Mbikqyres dhe te nagjshme	1,325	2,469
Shpenzime Auditimi	3,820	6,367
Marketing dhe te ngjashme	1,946	2,016
Transferata Udhetime	723	1,185
Shpenzime Komunikimi	1,993	2,911
Shpenzime Administrative pergjithshme	33,100	8,784
Penalitetet Gjore	86,395	43,729
Komisione Sherbime Bankare	2,260	1,933
Tjera	16,352	510
<b>Total</b>	<b>139,286</b>	<b>81,131</b>



Pascyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

## 22 Shpenzime personeli dhe të ngjashme

Shpenzimet personeli dhe të ngjashme analizohen si më poshtë .

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Pagat	607,425	574,504
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore	113,189	96,430
Kompensim Ushqimor	67,737	65,518
Shperblime dhe te ngjashme	80,746	35,097
<b>Total</b>	<b>869,097</b>	<b>771,549</b>

## 23 Shpenzime financiare

Ky zë përfshin rezultatin nga interesat që lidhen me huatë dhe atë nga këmbimi dhe rivlerësimi i gjëndjeve të llogarive, në vecanti, shpenzimet e interesave që përfaqësojnë shpenzimin në lidhje me kredinë afatgjatë që UKT ka përfutuar nga programet e zhvillimit.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Shpenzime interesa -Kredite22 MLD FROT/AID-95/007/00	10,818	15,167
Shpenzime interesa -kredia 13 mld F.ROT/AID-94/006/00	11,563	4,796
Shpenzime interesa -Kredia 53.2 F.ROT/AID-99/004/00	5,241	9,127
Shpenzime interesa -Kredi 6.8 F.ROT/AID-99/010/00	2,260	1,972
Shpenzime për interesa të kredisë për Blerjen e Hec	80,824	94,417
Shpenzime për interesa -Administrate overdraft	3,956	5,095
Shpenzime për interesa kredia Japoneze	214	6,557
Të tjera	(275)	(21)
<b>Total</b>	<b>114,601</b>	<b>137,110</b>

## 24 Shpenzime tatimore

Shpenzime tatimore analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Tatim fitimi korrent	(108,920)	(103,038)
Te ardhura tatimore të shtyra	15,863	-
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>93,057</b>	<b>103,038</b>

Llogaritja e tatim fitimit korrent analizohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>626,102</b>	<b>537,831</b>
Zhvlërësime tej normave fiskale	13,422	105,361
Gjoha, penalitete dhe të ngjashme	86,606	43,729
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>726,132</b>	<b>686,920</b>
Norma tatimit mbi fitimin	15%	15%
<b>Tatim fitimi korrent</b>	<b>108,920</b>	<b>103,038</b>

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

Zëri gjoba penalitete dhe të ngjashme përfaqeson gjoba të cilat UKT ka marrë kundrejt shoqërive të ndryshme përmbartimore për ceshtje që kanë humbur në shkallë të ndryshme të gjykatës administrative Tiranë gjatë vitit 2015 dhe 2014.

Levizjet në detyrimin tatimor të shtyrë i cili buron nga aplikimi i normave të ndryshme të amortizimit të aktiveve afatgjatamateriale mes atyre të aplikuara për qëllim raportimi financiar sipas SNRF dhe normave në fuqi sipas legjislacionit tatimor paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Gjëndja më 1 janar	16,534	-
Të ardhura tatimore të shtyra	(15,863)	16,534
Gjëndja më 31 dhjetor	671	16,534

## 25 Palët e lidhura

Palët konsiderohen të lidhura nëse njëra palë ka mundësinë të kontrollojë palën tjetër ose të ushtrojë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo vendimeve të tjera. Palët e lidhura përfshijnë aksionarët, drejtorët dhe entitete të lidhura me shoqëritë e Grupit.

	Detyrime	Shpenzime
<b>Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>		
Ministria e financave	1,031,747	-
Bordi mbikëqyrës	202	1,325
	<b>1,031,949</b>	<b>1,325</b>

	Detyrime	Shpenzime
<b>Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</b>		
Ministria e financave	886,462	-
Bordi mbikëqyrës	202	2,469
	<b>886,664</b>	<b>2,469</b>

Kompensimet për bordin mbikëqyrës gjatë vitit 2015 janë 1,325 mijë Lekë (2014: 2,469 mijë Lekë). Detyrimet për bordin mbikëqyrës më 31 dhjetor 2015 janë 202 mijë Lekë (2014: 202 mijë Lekë). Detyrimi i UKT për Ministrinë e Financave gjatë vitit 2015 dhe 2014 në lidhje me keestet e paguara nga Ministria e Financave për Kredinë ndaj BKT janë respektivisht 1,031,747 dhe 1,886,462.

## 26 Angazhime dhe detyrime të kushtezuara

### Çështje ligjore

Më 31 dhjetor 2015, ka disa çështje gjyqësore të ngritura kundër UKT Sh.a apo nga UKT Sh.a. Grupi mendon se këto çështje do të zgjidhen në favor të tij. Grupi nuk ka krijuar një fond zhvlerësimi në lidhje me detyrimet e mundshme që mund të lindin nga vendimet e gjykatave.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara  
31 dhjetor 2015  
Shumat paraqiten në mijë lekë nëse nuk shprehet ndryshe

#### *Legjislacioni tatimor*

Ligji Shqiptar për tatimet dhe doganat është objekt interpretimesh të ndryshme dhe ndryshimesh, të cilat mund të ndodhin shpesh. Interpretimi nga ana e manaxhimit të këtyre ndryshimeve ashtu si ato aplikohen në transaksionet dhe veprimtarinë e Grupit mund të kundërshtohen nga Autoritetet përkatëse.

Autoritetet tatimore shqiptare mund të mbajnë një qëndrim kundërshtues në lidhje me interpretimin e tyre të legjislacionit dhe vlerësimeve, dhe është e mundur që megjithëse transaksionet dhe aktivitetet nuk janë kundërshtuar në të shkuarën të mund të kundërshtohen gjithësesi.

Si rezultat i kësaj, mund të ketë vlerësime për tatime shtesë të rëndësishme, gjoba dhe interesa përkatës. Periudhat fiskale mund të qëndrojnë të hapura për t'u rishikuar nga autoritetet në lidhje me taksat deri në pesë vjet prej vitit të rishikimit.

#### **27 Ngjarjet pas datës së raportimit**

Gjatë vitit 2015 Shoqëria Gjoka Konstruksion sha ka situacionuar në shumën 208,369,437 lekë me TVSH UKT sha, por këto situacione nuk janë pranuar nga UKT sha. Situata është sistemuar gjatë vitit 2016, ku Gjoka Konstruksion dhe UKT sha me marrëveshje e kanë zgjidhur situatën duke rikontrolluar punimet e kryera dhe pranuar situacionet në vlerën 129,651,024 lekë me TVSH.

Nuk ka patur ngjarje të tjera pas datës së pasqyrave financiare që do të kërkonin shpjegim të mëtejshëm.

# Memo

## UJËSJELLËS KANALIZIME

TIRANË SH.A

nr. 3163 prot.

dt. 09.08.16



**Drejtuar:** Z. Redi Molla, Drejtor i Përgjithshëm  
**Nga:** Zj.Aida Sula, Drejtore e Drejtorisë Ekonomike  
**Datë:** Elona Allajbej, Përgjegjëse Sektori i Tatimeve dhe Taksave  
29.07.2016  
**Lënda:** Informacion mbi vendimin për miratimin e pasqyrave  
financiare

I nderuar z.Molla

Mbështetur në Ligjin nr.9723, datë 03.05.2007, " Për Regjistrimin e biznesit", I ndryshuar, neni 43, pika 3, subjektet kanë detyrimin të depozitojnë pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit pasqyrat financiare vjetore 2015, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit për këto pasqyra, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, brenda datës 31 Korrik 2016. Sipas nenit 74, pika 3 e këtij ligji, moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

Gjithashtu mbështetur në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, " Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar 33/1, pika 1 dhe 2, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinojnë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi. Shoqëritë tregtare dhe personat fizikë, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kalendarik, vendimin e organit përgjegjës/vendimin e personit fizik. Për paraqitjen me vonesë të këtij vendimi zbatohet një gjobë prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh për çdo muaj vonesë.

Ju informojmë se si pasojë e dorëzimit të raportit të auditimit nga ana e Grant Thornton shpk në datën 09/08/2016 nuk është marrë vendimi nga Asamblesja e Përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare dhe nuk është deklaruar pranë QKR-së dhe Tatimeve brenda afatit të përcaktuar në ligjet e sipërcituara.

Ju faleminderit!





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
info@ukt.al  
NIPT J620050020

A  
Elone  
arshave

Nr. 17235 Prot

datë 10.08 2016

**Drejtuar : Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë**

**Lënda: Relacion për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara për vitin 2015**

Shoqëria UKT sha me Vendimin e Asamblesë së Aksionerëve nr. 29 datë 9.12.2015 ka përzgjedhur kompaninë audituese Grant Thornton për të audituar pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2015.

Proçesi i auditimit ka filluar me vonesë në fund të muajit Prill 2016 pasi UKT po auditohej nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm ishte në dispozicion të tyre. Draft raporti u përgatit në fund të muajit Korrik dhe pasi u shqyrtua me UKT-në u dorëzua në datën 8/08/2016.

Në vijim ju paraqesin të dhënat e bilancit sipas zërave:

1. Aktivitet në vitin 2015 janë rritur me 7.4% krahasuar me vitet 2013 dhe 2014 duke kapur vlerën 17,150,672 mijë lekë. Ajo që ka ndikuar në këtë rritje vjen kryesisht nga shtimi i mjeteve monetare nga gjendjet në banka për shkak të arkëtimeve në rritje (nga 11,590 mijë lekë në 396,917 mijë lekë).
2. Pasivitet në vitin 2015 janë rritur me 8% krahasuar me vitet 2013 dhe 2014 duke kapur vlerën 17,150,621 mijë lekë. Zërat që kanë pësuar rritje janë fitimi i mbartur me rritje prej më shumë se dy herë, ulja e zërit të detyrimit afat-gjatë (detyrim tatimor i shtyrë pasi UKT sh.a. ka shlyer detyrimet e prapambetura). Tek detyrimet afat-shkurtra të gjitha zërat kanë pësuar ndryshime të ndjeshme. Konkretisht, janë shtuar detyrimet janë shtuar detyrimet ndaj të tretëve për blerje mallrash dhe shërbimesh prej 76%, janë shtuar detyrimet e personelit më shumë se dy herë (2.4 herë). Janë ulur detyrimet ndaj shtetit me 42%.
3. Fitimi neto është rritur me 22.5% (nga 434,793 mijë lekë në 533,045 mijë lekë).

Në vijim po paraqesim rezultatet më kryesore të auditimit:

- I. Emri i mirë ka lindur kur UKT sha. ka përthithur HEC Lanabregas. Ky emër lind kur vlera e paguar është më e madhe se vlera e drejtë e aktiveve neto. Klasifikohet si një aktiv jo-material, i cili në bazë standarteve IFRS nuk amortizohet, por vlera duhet të testohet çdo vit për çvlerësim.

Në momentin e përthithjes vlera e emrit të mirë të HEC-Lanabregas ka qënë 956,086 mijë lekë. UKT sha nëpërmjet vlerësueve të jashtëm të liçensuar ka kryer një vlerësim të aktiveve afat-gjata dhe vlera e testimit ka rezultuar me një rënie të vlerës së emrit të mirë prej 260,753 mijë lekë dhe norma e aktualizimit e përdorur është 8.7%. Sipas audituesit kjo normë aktualizimi nuk ka përfshirë koston e kapitalit, e cila do të ndikonte në një normë më të lartë dhe si pasojë në një rënie në vlerë të emrit të mirë.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)

NIPT J620050020

- II. Në zërin aktive në proces konstatohet vlera prej 1,026,003 mijë lekë të mbartur nga periudha të mëparshme për punime me nënkontraktorë në kuadër të kredisë italiane për Impjantin e Bovillës dhe Stacioni i Pompimit të Qafë Mollës, kredi e administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës Kanalizime (DPUK). Kjo vlerë nuk ka kaluar në zërin “Aktive” pasi procesi i marrjes në dorëzim nuk është përfunduar (DPUK dhe UKT). Lidhur me këtë çështje gjatë periudhës së auditimit UKT sh.a & audituesi ka kryer takim me DPUK për të sqaruar situatën dhe është konstatuar që UKT sh.a nuk ka rënë dakord me situacionet dhe nuk është bërë akti i marrjes në dorëzim.

Sipas audituesit për këtë çështje nuk ka dokumentacion të mjaftueshëm për të dhënë opinion.

Përsa më sipër UKT e konsideron të drejtë këtë konstatim dhe është menduar që në bashkëpunim me DPUK të bëhet një rivlerësim i vlerës si dhe marrja në dorëzim.

Në zërin e aktiveve “Toka” vlerësimi prej 2,155,486 mijë lekë është bazuar në raportin e datës 27 Mars 2014 dhe nuk është e qartë metoda e aplikuar për vlerësimin e këtij aktivi. Audituesi është shprehur se nuk ka sigurinë në lidhje me rregullimet për këtë zë. UKT sh.a. do ta mbajë parasysh këtë rregullim kur të kryhet vlerësimi i rradhës i aseteve të shoqërisë dhe kjo do të pasqyrohet në planin e punës 2016-2017.

- III. Në lidhje me “Llogaritë e arkëtueshme” me vlerë 2,716,829 mijë lekë të cilat janë detyrimet e abonentëve kundrejt UKT-së në vite, UKT ka kryer një zhvlerësim duke përcaktuar klasat e riskut me përqindjet përkatëse, por nuk ka një studim të mirëfilltë për të justifikur masën e këtyre përqindjeve. Audituesi është shprehur se kërkohet një vlerësim individual për balancat e arkëtueshme individualisht të rëndësishme dhe vlerësim kolektiv për balancat e tjera bazuar në analizë të plotë mbështetëse mbi të dhënat historike.

Nga vetë specifika e aktivitetit të shoqërisë UKT sh.a nuk kryen analiza individuale për abonentët duke qenë se uji është e drejtë kushtetuese dhe është një detyrim moral që çdo qytetar apo subjekt të furnizohet me ujë. E vetmja politikë diferencuese shprehet në politikat e çmimit që lehtësojnë aftësitë paguese, politika të cilat janë miratuar nga ERRU.

UKT sh.a ka kryer vlerësim kolektiv (kategori, mënyra e faturimit dhe mosha e borxhit) mbi bazë historike që nga viti 2008. Ky vlerësim është marrë për bazë në klasifikimin e klasave të riskut.

- IV. Lidhur me çështjet gjyqësore të paraqitura në bilanc me vlerën 100,961 mijë lekë UKT sh.a nuk ka krijuar dhe vlerësuar një fond provigjione për çështjet në gjykata. Si rezultat audituesi nuk mund të kryejë rregullime.

Përsa më sipër UKT sh.a e ka zgjidhur këtë çështje në buxhetin e vitit 2016.

- V. Lidhur me grantet qeveritare të cilat janë dhënë ndër vite për vlerën 494,103 mijë lekë dhe 509,383 mijë lekë audituesi shprehet se nuk ka patur dokumenta të mjaftueshme në dispozicion



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)

NIPT J620050020

dhe nuk ka marrë konfirmim nga Ministria e Financave (Drejtoria e Thesarit). Audituesi është shprehur se në rast se nuk ka dokumentacion justifikues atëherë këto vlera mund të kalojnë/njihen si e ardhur në bilancin e vitit 2016.

- VI. Lidhur me vlerësimin e pasqyrave financiare të vitit 2014 të audituara nga një tjetër auditues për zërin "Të ardhura" Grant Thornton është shprehur se nuk ka evidencë të mjaftueshme për t'i konfirmuar te ardhurat e vitit 2014 në mënyrë që të shërbejë si bazë krahasimore me qëllim dhënien e opinionit për të ardhurat e vitit 2015.
- VII. Normat e amortizimit për të ardhurat ose shpenzimet sipas kategorive janë miratuar me vendimin nr. 16 datë 23.12.2013 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve. Audituesi sugjeron që në bazë të standarteve ndërkombëtare IFRS këto norma duhen rishikuar çdo vit.

UKT sha rekomandon ta bëjë pjesë të planit të punës 2016-2017.

Në përfundim për të gjitha çështjet e lëna nga audituesi Grant Thornton i kërkojmë Këshillit Mbikqyrës të miratojë Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të UKT sha të vitit 2015 dhe në zbatim të rekomandimeve të lëna të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm të UKT-sha të miratojë planin e punës 2016-2017.

